

Shpresa Musaj

Prejardhja ilire e emrit Kosova

Një analizë gjuhësore krahasuese

Pjesa e parë

Hyrja

Në qëndër të kësaj analize do të jetë emri Kosova dhe prejardhja gjuhësore e kësaj fjale, e cila do të analizohet nga këndvështrimi gjuhësor, një aspekt pothuaj i paprekur tek studimet e gjuhësisë shqiptare të deritanishme.

Fjala Kosova do të jetë objekt i krahasimeve të ndryshme gjuhësore, të cilat do të zhvillohen nga këndvështrime të ndryshme, me synimin për të hedhur dritë mbi ato informacione gjuhësore që kjo fjalë ruan në vetvete, sepse ato sjellin faktet gjuhësore që mundësojnë dhe të vetmet që lejojnë përcaktimin e një fjale tek një gjuhë e caktuar.

Për prejardhjen e këtij emri nga gjuha sllave është thënë dhe shkruar shumë, por nuk është folur kurrë për prejardhjen e kësaj fjale nga gjuha ilire, para së gjithash, sepse ky emërtim gjendet në ato treva, të cilat kanë qënë në antikitet vetëm vendbanime të fiseve ilire dhe logjika e parë duhet të çonte tek ideja e prejardhjes së këtij emërtimi nga gjuha ilire. Për këtë arsye fokusi i kësaj analize do të drejtohet tek krahasimi i fjalës Kosova me emërtimet ilire të antikitetit, nga këndvështrimi i gjuhës ilire dhe mbi bazën e materialit gjuhësor të trashëguar nga ilirishtja.

Ideja sunduese e deritanishme ka qënë, që gjuha ilire e shkruar nuk ekziston, materiali i ilirishtes nuk ekziston dhe nuk ka studime mbi ilirishten - një ide, e cila na u imponua për dekada me radhë, ndërkohë që e kundërta e saj është e vërteta: ilirishtja e shkruar ekziston, materiali mbi ilirishten është mbledhur, analizuar dhe studiuar nga gjuhëtarët gjermanë të fundit të shekullit të 19 dhe fillimit të shekullit të 20, të cilët kanë bërë me dhjetëra studime mbi gjuhën ilire.¹

Për këto studime nuk është folur kurrë dhe vazhdohet të heshtet deri në ditët e sotme. Ato anashkalohen dhe është bërë çdo përpjekje për ti lënë në harresë duke na hequr kështu njohuritë thelbësore mbi zhvillimin e gjuhës sonë si dhe mundësinë për të vendosur mbi bazën e fakteve gjuhësore lidhjen e shqipes me ilirishten. Për këtë arsye ka qënë e pamundur deri tani që të bëhej një analizë krahasuese gjuhësore mbi emrin Kosova, e cila do të hidhte dritë mbi prejardhjen e këtij emri nga gjuha ilire dhe do ta vendoste diskutimin akademik mbi baza të argumentuara dhe shkencore në lidhje me këtë temë.

1 Tek këto studime u analizua jo vetëm materiali i mbledhur nga gjuha ilire, por gjuha ilire u krahasua edhe me gjuhët e ndryshme të antikitetit, midis të tjerash edhe me gjuhën e popujve pellazgë. Nëpërmjet analizës gjuhësore krahasuese të këtyre dy gjuhëve gjuhëtarët gjermanë do të vendosnin lidhjen midis gjuhës ilire dhe gjuhës së fiseve pellazge dhe duke u mbështetur tek faktet gjuhësore do të arrinin në përfundimin që ilirishtja dhe pellazgjishtja ishte e njëjta gjuhë, që fiset pellazge ishin të njëjtë me fiset ilire nga ana etnike dhe që grekët kishin ardhur shumë vonë në këto treva, ku ata janë sot. Bëhet fjalë jo për një studim, por për dhjetëra studime të kryera në një periudhë gati 100 vjeçare, 1860 – 1960, pra pothuaj tre gjeneracione studiuesish, të cilët njihen si emrat më të shquar në fushën e Gjuhësisë Krahasuese, në shkallë Europiane dhe botërore, dhe të cilët do të arrinin tek i njëjti përfundim tek të gjitha studimet e tyre: që ilirishtja ishte e njëjta gjuhë me pellazgjishten dhe si rrjedhim do të vendosnin edhe lidhjen e tyre me shqipen sotme. Për të arritur tek ky përfundim ata u mbështetën tek të dhëna të fushave të ndryshme, historike, arkeologjike, kulturore, mitologjike, etj, por veçanërisht dhe para së gjithash tek faktet gjuhësore të nxjerra nga analiza krahasuese e këtyre gjuhëve. Këto studime kanë vlera të rëndësishme në fushën e gjuhësisë prandaj ato nuk mund të anashkalohen edhe sot, nga ata gjuhëtarë që merren me studimin e këtyre gjuhëve.

Kjo analizë gjuhësore do të mbështetet pikërisht tek këto studime mbi gjuhën ilire, tek rezultatet e punës së këtyre gjuhëtarëve, tek faktet gjuhësore që ata sollën në veprat e tyre, tek krahasimet gjuhësore që ata bënë në studimet e tyre si dhe tek materiali i ilirishtes² tek i cili ata u mbështetën për të bërë këto krahasime.

Vetëm mbi bazën e këtyre njohurive mbi gjuhën ilire bëhet i mundur krahasimi i kësaj fjale me emërtimet ilire të antikitetit dhe analiza e formës së saj gjuhësore sipas veçorive të gjuhës ilire.

Për krahasimet që do të zhvillohen tek kjo analizë do të përdoret Metoda Krahasuese³ që gjuhëtarët gjermanë të kësaj periudhe përdorën në studimet e tyre për të krahasuar gjuhët e antikitetit në përgjithësi si dhe për studimet e tyre mbi gjuhën ilire në veçanti.

Në pjesën e parë të kësaj analize emri Kosova do të krahasohet nga ana gjuhësore me emërtimet ilire të antikitetit si dhe me emërtimet e sotme, të cilat tregojnë ngjashmëri në formën e tyre fjalëformuese me emrin Kosova.

Në pjesën e dytë të kësaj analize do të bëhet analiza gjuhësore e vetë fjalës Kosova, ku do të analizohet struktura e fjalës, mënyra e fjalëformimit si dhe elementët e saj fjalëformues duke u mbështetur mbi të dhënat dhe ligjet gjuhësore të ilirishtes dhe shqipes si dhe do të analizohet procesi transformues gjuhësor nëpër të cilin ka kaluar kjo fjalë nga periudha ilire deri sot.

Prejardhja e emrit Kosova ka tërhequr në mënyrë të vazhdueshme vëmendjen e botës akademike dhe është bërë shpesh objekt diskutimi jo vetëm i saj, por edhe i rrjeteve sociale dhe bisedave private.

Si rrjedhojë e kësaj analize krahasuese është hedhur dritë mbi një numër të konsiderueshëm faktesh gjuhësore, të cilat vendosin lidhjen e drejtpërdrejtë midis formës së sotme të emrit Kosova dhe emërtimeve ilire të antikitetit dhe njëkohësisht vërtetojnë prejardhjen e këtij emërtimi nga gjuha ilire, praninë e tij të vazhdueshme tek e folura e popullsisë iliro-shqiptare nga periudha ilire deri në ditët e sotme.

Rezultatet e kësaj analize krijojnë një bazë të sigurtë për të argumentuar me fakte gjuhësore prejardhjen ilire të emrit Kosova si dhe për të pranuar si fakt të vërtetuar përkatësinë e kësaj fjale tek fondi i shqipes së sotme, të cilën ajo e ka trashëguar nga ilirishtja.

Kjo analizë gjuhësore është ndërtuar në mënyrë të tillë, që për çdo krahasim gjuhësor bëhen përgjithësime dhe arrihet në një përfundim të caktuar. Këto përgjithësime pasojnë dhe plotësojnë njëra-tjetrën dhe krijojnë sëbashku corpusin e dëshmive gjuhësore, të cilat çojnë tek rezultatet përfundimtare

2 Tek vendbanimet e fiseve ilire të Gadishullit Apenin janë gjetur ato shkrime, të cilat njihen në gjuhësinë Europiane të fillimit të shekullit 20 me emrin “Shkrimet ilire”. Për këto shkrime është përdorur edhe termi “Shkrimet Messape dhe Venete”, sipas emrave të fiseve, tek vendbanimet e të cilëve janë gjetur këto shkrime: në pjesën jugore të Gadishullit Apenin, në zonën Apulo-Kalabreze, i kishte vendbanimet e tij, fisi ilir i Messapëve, Messapioi, ndërsa në pjesën veriore të këtij Gadishulli i kishte vendbanimet e tij fisi ilir i Venetëve. Këto shkrime janë dëshmi e ilirishtes së shkruar! Materiali mbi ilirishten nuk është aq i gjerë si materiali i latinishtes, por studimi i tij ka dhënë njohuri të rëndësishme mbi gjuhën ilire, të cilat duhet ti njohim si pjesë të gjuhës dhe të historisë së gjuhës sonë. Ekzistenca e këtij materiali e vendos shqipen e shkruar në mijëvjeçarin e fundit para erës sonë dhe jo në shekullin e 15, siç na është imponuar për dekada me radhë, sepse si pasardhëse e ilirishtes, shqipja e shkruar i ka fillimet e saj pikërisht tek këto shkrime ilire.

3 Kjo Metodë krahasuese u përdor nga gjuhëtarët gjermanë të gjysmës së dytë të shekullit të 19 deri në gjysmën e parë të shekullit të 20 për të bërë krahasimin e gjuhëve të vjetra të antikitetit, të cilat nuk fliteshin më dhe të gjuhëve të kohëve historike, midis tyre edhe krahasimin midis gjuhës ilire dhe gjuhës së fiseve pellazge.

Emërtimet ilire dhe lidhja e tyre me emrin Kosova

Hapi i parë për të analizuar emërtimin e sotëm Kosova dhe për të bërë krahasimin e tij me emërtimet ilire të antikitetit është krahasimi i formës gjuhësore së kësaj fjale me ato emërtime ilire, të cilat kanë në përbërjen e tyre elementë të njëjtë, ose të ngjashëm gjuhësor. Për këtë arsye vëmendja e kësaj analize do të drejtohet në radhë të parë tek krahasimi i rrënjëve të fjalëve mbi bazën e të cilave emërtimi Kosova dhe emërtimet ilire janë ndërtuar dhe në vazhdim do të krahasohen edhe mënyra e fjalëformimit si dhe elementët fjalëformues në strukturën e fjalës së tyre, sepse këto krahasime sjellin ato fakte gjuhësore, të cilat lejojnë përcaktimin e fjalës Kosova tek një gjuhë e caktuar. Fillimisht do të kërkojmë në fondin e emërtimeve ilire, ato emërtime, të cilat kanë në përbërjen e tyre një rrënjë fjale ose të njëjtë ose të ngjashme me rrënjën *kos të emrit të sotëm Kosova.

Pohimi i parë më i rëndësishëm në këtë analizë gjuhësore është fakti që gjuha ilire i njëj emërtimet e krijuara mbi bazën e rrënjës *kos. Si shembull të emërtimeve të krijuara mbi bazën e kësaj rrënje gjuhëtarët përmendin emërtimin e lumit Cosa/Kosa në Venezien antike në Gadishullin Apenin, në zonën e Tagliamentos, ku kishte vendbanimet e tij fisi ilir i Venetëve.⁴

Në këtë grup emërtimeve ata fusin edhe emrin e lumit Apsos në Iliri. Emri i këtij lumi përbëhet nga dy elementë fjalëformues, nga elementi *ap dhe elementi *sos. Elementi fjalëformues *ap shfaqet shpesh tek emërtimet e vendbanimeve ilire, veçanërisht tek emërtimet e lumenjve dhe është pranuar si element tipik i ilirishtes.⁵ Për analizën gjuhësore që po trajtojmë merr rëndësi pjesëza/fjala fjalëformuese *sos, e cila është e lidhur në kompozitë me elementin ilir *ap dhe është e ngjashme me formën *cos = *kos të rrënjës së emrit të lumit Cosa.

Në grupin e emrave të krijuar me rrënjën *kos gjuhëtarët fusin edhe emrin e lumit Cusus/Kusus, një degë në lindje të lumit March në veri të Danubit, në Gjermani. Emri i këtij lumi është përcaktuar si emër ilir, sepse ndodhet në ato vise, të cilat në antikitet kanë qënë të banuara nga fiset Ilire.⁶

4 Një nga rezultatet e studimeve të gjuhësisë krahasuese do të përshkruhet në mënyrë të përmbledhur si në vijim: Pothuaj i gjithë Gadishulli Apenin, Italia e periudhës antike, ka qënë në antikitet e banuar nga fise të ndryshme ilire, duke filluar nga periudha para Luftës së Trojës dhe deri në periudhën romake. Për emërtimin e të gjithë këtyre fiseve është përdorur në histori dhe gjuhësi shpesh një emër i përbashkët: për fiset ilire, të cilat i kishin vendbanimet e tyre në pjesën jugore të Gadishullit Apenin, është përdorur emri “fiset ilire Apulo-Kalabreze”, të cilët njihen edhe me emrin fiset “Messape dhe Iapige”, ndërsa për fiset ilire, të cilët i kanë patur vendbanimet e tyre në pjesën qendrore dhe Veriore të Gadishullit Apenin është përdorur emri “Fiset Venete”. Në çdo hap që të hedhësh në këtë Gadishull, thotë gjuhëtari gjerman Krahe, do të takosh emërtime ilire.

5 Kudo ku takohen emërtime të krijuara mbi bazën e elementit *ap, ato janë përcaktuar si emërtime ilire. Si shembull të këtyre emërtimeve sjellim emrin e fisit ilir të Messapëve, Messapioi. Emri “Messap” është krijuar me anë të elementëve *ap dhe *mes, të cilat kanë patur tek ilirishtja kuptimet *ujë” dhe “mes”, prandaj e gjithë fjala ka patur kuptimin “në mes të ujrave”. Tek venetishtja gjuhëtarët shikojnë dialektin ilir të gegërishtes, ndërsa tek gjuha e fiseve Apulo-Kalabreze në jug, ata shikojnë dialektin e toskërishtes.

6 Gjuhëtarët e Gjuhësisë Krahasuese kanë arritur në përfundimin që në mijëvjeçarin e fundit para erës sonë hapësira të mëdha të Europës kanë qënë të banuara nga fise të ndryshme ilire: Europa qendrore - Gjermania e sotme, Zvicera, Austria, Polonia, Çekia deri në vendet Baltike në veri, si dhe pjesë të mëdha të Belgjikës, të Hollandës dhe Francës deri në ishullin Britanik në veriperëndim, por edhe Hungaria dhe Rumania në lindje, kanë qënë të banuara gjatë gjithë këtij mijëvjeçari nga fise të

Ata e krahasojnë emërtimin *Cusus me emrin ilir *gutso/s, kuptimi i të cilit tek ilirishtja ka qënë “ujë që shkumëzon”. Në këtë grup bëjnë pjesë dhe emërtimet Cusum, një qytet në Panonien, në Hungarinë e sotme, ku ka patur vendbanimet fisi ilir i Panonëve si dhe fise të tjera ilire.

Këtij grupi emërtimesh i përkasin edhe dy emërtime të tjera, të cilave do t’ju kushtohet një vëmendje e veçantë në këtë analizë gjuhësore, sepse ato takohen në trevat e Dardanisë, pikërisht në ato vise ku shtrihet Kosova e sotme.

Tek këto dy emërtime të sjella nga Jokli, bëhet fjalë për emrin e një vendi në Dardani, i cili njihet me emrin ilir *Kousines, si dhe për emrin e një kështjelle po në Dardani, e cila mbante të njëjtin emër, *Kousines. Të dyja këto fjalë futen në grupin e fjalëve ilire të krijuara mbi bazën e rrënjës *cos/*kos. Ky fakt tregon që Dardanët e këtyre trevave e njihnin dhe e përdornin në emërtimet e tyre elementn gjuhësor *kos.

Emri Kosova është krijuar mbi bazën e rrënjës *kos = *cos e cila përputhet plotësisht me rrënjët e emërtimeve ilire që u përmendën më lartë. Kjo përputhje midis rrënjës së emrit Kosova dhe rrënjëve të emërtimeve ilire, është edhe dëshmia e parë e rëndësishme gjuhësore, që vendos lidhjen e drejtpëdrejtë midis emrit Kosova dhe emërtimeve ilire, ose më saktë midis rrënjës fjalëformuese ilire *cos/*kos dhe rrënjës së emrit Kosovë. Kjo përputhje e plotë gjuhësore e vendos emrin Kosova më tej në familien gjuhësore të emërtimeve ilire, të cilat kanë në përbërjen e tyre të njëjtën rrënjë fjale.

Këtë metodë krahasuese kanë përdorur edhe gjuhëtarët e gjuhësisë krahasuese për të përcaktuar përkatësinë e një emri në një grup/familie të caktuar gjuhësore. Emërtimet e krijuara mbi bazën e së njëjtës rrënjë janë përcaktuar si emërtime ilire, edhe kur ato shfaqeshin largë atyre trevave, të cilat ishin të njohura në antikitet si vendbanime të fiseve ilire.⁷

Këtu duhet të vëmë në dukje që tek përcaktimi i një emërtimi tek një familje e caktuar gjuhësore, bëhet fjalë për emërtimet ilire të antikitetit, ndërkohë që midis emrit të sotëm Kosova dhe emërtimeve ilire të antikitetit qëndron në mes faktori kohë. Për të treguar që kemi të bëjmë me të njëjtat emërtime, apo me emërtime të ngjashme të së njëjtës familje gjuhësore, është e dosomsdshme analiza krahasuese gjuhësore midis emërtimeve të sotme dhe emërtimeve ilire të antikitetit, e cila na përcjell ato informacione gjuhësore, që kapërcen faktorin “kohë” midis këtyre emërtimeve.

ndryshme ilire. Fiset ilire kishin qënë gjatë gjithë kësaj epoke në stadin e një zhvillimi shumë të lartë dhe kanë emërtuar me fjalët e gjuhës së tyre vende të ndryshme në Europë: malet dhe vargmalet më të njohur të saj, lumenjtë më të rëndësishëm, luginat dhe liqenet më të mëdhenj, si dhe një numër i madh vendesh dhe vendbanimesh mbajnë emra ilir, tek të cilat këto fise do të linin gjurmët e ekzistencës së tyre. Edhe emri i detit Baltik është përcaktuar prej gjuhëtarëve gjermanë si emër ilir, të cilët e lidhin kuptimin e fjalës “Baltik” me emrin ilir *balt, të cilën e gjejmë me këtë kuptim edhe tek shqipja e sotme. I gjithë ky mijëvjeçar ka qënë i njohur në historinë e Europës deri në vietet 30 të shekullit të 20 me emrin “Epoka ilire”. Kulturat e ndryshme që kanë lulëzuar gjatë këtij mijëvjeçari në kontinentin European kanë qënë kultura ilire. Shqipja e sotme është ura lidhëse me historinë më të hershme të kontinentit tonë.

⁷ Në bazë të kritereve të Gjuhësisë Krahasuese emërtimet e krijuara me anë të rrënjës *cos = *kos, të cilat i gjejmë tek vendbanimet ilire në pjesën jugore të Europës, në Gadishullin Apenin dhe në Ballkan, i cili është njohur me emrin Gadishulli Ilirik, janë dëshmia kryesore që vërtetojnë që edhe emërtimet e krijuara me këtë rrënjë *cos = *kos, kudo në Europë, janë emërtime ilire. Kjo dëshmi përdoret në mënyrë reciproke për të dyja kahet, si fakt që vërteton prejardhjen ilire të këtyre emërtimeve.

Fillimisht duhet të theksojmë dy fakte të rëndësishme: e para, ekzistencën e emërtimeve ilire të krijuara me rrënjën *kos njëloj si emri Kosova dhe e dyta që emri Kosova takohet tek ato treva, të cilat kanë qënë në antikitet të banuara nga fiset ilire.

Në mungesë të të dhënave të drejtpërdrejta nga periudha antike mbi emrin Kosova, lidhjen midis këtij emri dhe emërtimeve ilire të krijuara me të njëjtën rrënjë, e vendosin në radhë të parë ato emërtime ilire që gjenden në trevat e Dardanisë, në ato vise ku shtrihet Kosova e sotme. Njëri prej këtyre emërtimeve është emri ilir Kousines.

Krahasimi midis këtyre dy emërtimeve do të bëhet për dy arsye: e para sepse emri Kosova dhe emërtimi Kousines tregojnë ngjashmëri gjuhësore midis tyre, dhe e dyta duke u mbështetur tek fakti që emërtimi Kousines takohet dy herë në Dardani, në trevat e Kosovës së sotme, mendohet që ky emërtim, ose një emërtim i ngjashëm me të, të ketë qënë baza e prejardhjes së emrit të sotëm Kosova. Për këtë arsye emri ilir Kousines do të bëhet objekt i analizës krahasuese në vijim, për të parë lidhjet gjuhësore midis tij dhe formës së sotme të emrit Kosova.

Një kërkim dhe studim më i zgjeruar do të na sillte emërtimet ilire të Dardanisë, të cilat kanë në përbërjen e tyre rrënjën *kos dhe të cilat bëjnë pjesë në të njëjtën familie gjuhësore, si emërtimi Kousines. Por edhe krahasimi i emrit Kosova me emrin Kousines sjell faktet gjuhësore themelore që vendosin lidhjen këtij emri me emërtimet ilire të antikitetit.

Në përbërjen e rrënjës *kous të emërtimit *Kousines vihet re togu zanor *ou, tek rrënjët e emërtimeve Cusus dhe Cusum dhe tek rrënja e fjalës ilire *gutso/s, që u përmendën më lartë vihet re zanorja *u, ndërkohë që rrënjët e emërtimeve ilire Cosos dhe Apsos shfaqen me zanoren *o. Fakt është që gjuhëtarët i fusin të gjitha këto emërtime në grupin e fjalëve ilire të krijuara me rrënjën *cos, pra tek emërtimet që kanë në formën e rrënjës së tyre zanoren *o. Nga ana tjetër vetë ilirishtja e njeh këtë mënyrë fjalëformimi edhe për grupe të tjera fjalësh. Tek emërtimet ilire të së njëjtës familie gjuhësore gjejmë shpesh emërtime, të cilat shfaqen njëherë me zanoren *o, njëherë me zanoren *u dhe njëherë me togun zanor *ou.

Si shembull përmendim emrin e fisit ilir të Morgetes në gadishullin Apenin, Italinë antike, i cili ishte larguar nga Bruttii për në Siqeli, qyteti kryesor i të cilëve mbante emrin Murgantia. Këtu vihen re dy forma të së njëjtës fjalë, Morgetes dhe Murgantia, të cilat shfaqen në rrënjën e tyre fjalëformuese njëherë me zanoren *o dhe njëherë me zanoren *u.

Forma të tjera me zanoren *u, të cilat bëjnë pjesë tek ky grup emërtime, i gjejmë tek emrat e lumenjve Murg i poshtëm dhe i sipërm, degë të Rhein/it në Gjermani, të cilët njihen edhe me formën Murga dhe të cilët janë përcaktuar si emërtime ilire.⁸ Murg quhet edhe një degë e lumit Thur, degë e Rhein/it në Zvicër, i cili po ashtu është emërtim ilir.

⁸ Në mijëvjeçarin e fundit para erës sonë pothuaj e gjithë Gjermania e sotme ka qënë e banuar nga fise të ndryshme ilire. Edhe sot gjenden në Gjermani një numër i madh emërtime, si emra lumenjsh, malesh, vendbanimesh, ... etj, të cilat gjuhëtarët gjermanë i përcaktuan në studimet e tyre si emërtime ilire.

Në këtë grup fusin gjuhëtarët edhe emrat e lumenjve Morge - degë e lumit Allier, emrin e lumit tjetër Morges - degë e lumit Isere, emrin e lumit Morgen - degë e lumit Saone si dhe emrin Morge - degë e një lumi në liqenin e Genfer/it, të cilët janë përcaktuar si emërtime ilire. Gjuhëtarët përmendin në këtë grup edhe emrin e një vendi që quhej Morginum, i cili sot mban emrin Moirana. Ky vend e ka marrë këtë emër nga emri i lumit Morge, pranë të cilit ai ndodhet. Dukuria e emërtimeve të vendeve dhe vendbanimeve sipas emrit të lumenjve në bregun e të cilave ato ndodheshin, është njohur si dukuri tipike ilire.⁹

Si përfundim mund të themi që emërtimeve ilire, të cilat i përkasin së njëjtës familie gjuhësore, shfaqen tek ilirishtja këmbësorë, njëherë me zanoren *o dhe njëherë me zanoren *u. Fakti që këtë veçori e gjejmë tek familje të ndryshme gjuhësore të emërtimeve ilire, ajo është treguese që kemi të bëjmë me një dukuri gjuhësore, e cila nga ana e saj merr një rëndësi të veçantë në krahasimet midis emërtimeve ilire dhe emërtimeve të sotme, sepse ajo është një prej treguesve gjuhësor që vendos lidhjen midis emrit Kosova dhe emërtimeve Kousines.

Emërtimi Kousines shfaqet me togun zanor *ou në rrënjën e tij, por bën pjesë tek familia gjuhësore e emërtimeve, të cilat kanë në rrënjën e tyre zanoren *o, si tek forma *kos. Shembuj të ngjashëm takojmë shpesh tek emërtimeve të së njëjtës familie ilire.

Si shembull nga ilirishtja, ku vihet re kjo dukuri përmendim fjalën e ilirishtes “Bora”, e cila e ka prejardhjen, sipas gjuhëtarëve, nga rrënja e fjalës indogjermane idg. goura. Kjo e fundit ka patur në ilirisht sipas tyre kuptimin *mal, ndërsa kuptimin e rrënjës së kësaj fjale *goura, ata e lidhin me fjalën *gur të shqipës së sotme. Tek ky shembull vihet re që rrënja e indogjermanishtes me togun zanor *ou shfaqet tek fjala ilire *bora me zanoren *o.

Tek ilirishtja takojmë edhe grupe fjalësh tek të cilat togu zanor *ou shfaqet me zanoren *u. Si shembull për këtë grup përmendim emërtimeve të krijuara mbi bazën e rrënjës ilire *bounos¹⁰. Tek vendbanimet ilire të Apuliens, në zonën ilire Apulo-kalabreze të Italisë antike, gjendet emërtimi Bounos. Me emrin Bounous ishte emërtuar edhe një vend në Maqedoni. Në këtë grup futet edhe emërtimi Bounima në Epir,¹¹ i cili është përcaktuar si emërtim ilir, si dhe emri ilir për persona Bounimos.

Në këtë grup bën pjesë edhe emërtimi Bunos në Iliri, ku vihet re forma me zanoren *u në rrënjën e kësaj fjale.¹² Këtu do të përmendja edhe emrat e lumenjve *Buna dhe Valbona në Shqipëri, të cilët bëjnë pjesë në të njëjtin grup gjuhësor dhe shfaqen në rrënjën e tyre njëherë me zanoren *u tek emri Buna dhe njëherë me zanoren *o tek pjesa *bona e fjalës Valbona.

9 Si shembull sjellim emërtimin Tarent, i cili gjendet pranë lumit Tara në Gadishullin Apenin.

10 Kjo fjalë ka patur tek ilirishtja kuptimin *kodër.

11 Gjuhëtarët fusin në këtë grup gjuhësor edhe dy emërtime të tjera: emërtimin Boua në Achaia, tek fiset pellazge të Greqisë paragreke, si dhe emrin Bourala të përmendur nga Stephan Byzantinus tek fiset pellazge të Epirit. Sipas gjuhëtarëve gjermanë, Epiri i periudhës antike ka qënë i banuar nga fiset pellazgo-ilire dhe tregues i pranisë së tyre janë numri i madh i emërtimeve ilire që gjenden tek të gjitha ato treva, që njiheshin në antikitet dhe sot me emrin Epir.

12 Rrënja e emërtimeve Bunos është *bunë dhe tek ilirishtja kjo fjalë ka patur sipas gjuhëtarëve kuptimin *kasolle.

Nga fondi i emërtimeve ilire, të cilat janë tregues të kësaj dukurie ilire, ku rrënjët e emërtimeve shfaqen ose me togun zanor *ou, ose me zanoren *u, ose me zanoren *o, sjellim si shembull emrin e fisit ilir *Kalouxones (lexo kalouksones) të përmendur nga Ptolemaoes. Ky fis ilir i ka patur vendbanimet e tij në anë të Elbës, në Gjermaninë antike¹³.

Emrin e këtij fisi gjuhëtarët e shikojnë të njëjtë me emrin e fisit ilir të Alpeve *Calucones (lex. Kalukones)¹⁴ prandaj edhe fisi *Kalouxones është përcaktuar fis ilir. Në këtë grup emrash ata fusin edhe emrin e portit *Caloucianus në Salonaë, në Dalmaci, si dhe emrin e fisit Kaloikinoi në Iliri dhe në Kalabrie, në Gadishullin Apenin. Tek kjo paraqitje vihet re, që emra të fiseve ilire, të cilët i kishin vendbanimet e tyre në Iliri¹⁵ dhe në Gadishullin Apenin, takohen përsëri në pjesën veriore të Europës. Ky fakt ka rëndësi të madhe për krahasimet në fushën e Gjuhësisë e Krahasuese për të përcaktuar prejardhjen gjuhësore të një fjale si dhe përkatësin e saj tek një gjuhës e caktuar, dhe bashkë me këtë përcaktim edhe prejardhjen etnike të popujve që njiheshin me këtë emër.

Në këtë grup gjuhëtarët fusin edhe emërtimin Kalisia në Oberschlesien, i cili është krijuar, sipas tyre, njëlloj si emri i fisit Kaloikinoi në Iliri, me anë të rrënjës *kal dhe mbaresës *isia, ku mbaresa *isia është e njëjtë me mbaresën e emërtimit tek tjetër ilir Ulcisia. Edhe mbaresa *isia është përcaktuar si mbaresë ilire.

Tek emërtimet e tre fiseve të para vihet re që togu zanor *ou tek emri Caloucianus (*lou) shfaqet tek emri Calucones me zanoren *u (*lu), dhe tek emri Kaloikinos me togun *oi, pra me zanoren *o (*loi). Tek të tre këta emra kemi format në vijim: lou - lu - lo/i. Këtu do të vëmë në dukje që togun zanor *ou të rrënjës së fjalës Kousines e gjejmë përsëri tek këto emërtime: Caloucianus - Kousines

Për tu vënë në dukje është ngjashmëria e formave të emrave të fiseve që u përmendën më lartë dhe formës së fjalës Kousines në Dardani, të cilat tregojnë ngjashmëti veçanërisht tek elementët e tyre përbërës fjalëformues. Caloucianus - Kousines

Pjesa e dytë e emërtimit *Caloucian/us, pra forma (*oucian) është plotësisht e njëjtë me pjesën (*ousin) të emërtimit Kousines: Cal/oucian/us = K/ousin/es. Pjesët përbërëse të këtyre dy emrave “oucian” dhe “ousin” janë plotësisht të njëjta. Më poshtë do ti gjeni format e këtyre emërtimeve në formë tabele, ku vihet re qartë ngjashmëria midis elementëve të tyre përbërës fjalëformues.

Kaloikinos

13 Në mijëvjeçarën e fundit para erës sonë, pothuaj e gjithë Gjermania e sotme ka qënë e banuar nga fiset ilire, gjurmë të ekzistencës së të cilëve i gjejmë tek emërtimet gjeografike të shpërndara në të gjithë Gjermaninë. Keltët do të vinin shumë më vonë, në viset e Gjermanisë së sotme, afërsisht rreth shek. të 4 ose 3 p.e.s., ndërsa fiset gjermane mendohet të kenë lëvizur nga veriu i Europës drejt jugut, drejt viseve të Gjermanisë së sotme në periudhën e kapërcimit të mijëvjeçarëve.

14 Alpet e Europës kanë qënë vendbanime të fiseve të ndryshme ilire. Zvicera është njohur në antikitet me emrin Raetia ilire, kurse Austria njihet me emrin ilir Norikum. Këtë emër e gjejmë edhe sot në Shqipëri tek emri Orikum në Vlorë.

15 Emri Ilir, i cili tek shqipja e sotme paraqitet me shkrim në formën “Ilir”, ka patur në antikitet formën “Illyrier”. Me formën *Illyrier kjo fjalë merr një kuptim tjetër nga kuptimi ilir. Si pasardhës të fiseve ilire, ne duhet të njohim atë formë të shkruar me të cilin ky emër njihet nga shkrimet e antikitetit dhe do të ishte mirë që të përdornim edhe këtë formë të shkruar të këtij emri: Illyrier. Për arsye kuptimi do të përdoret në këtë analizë gjuhësore forma me të cilin ky emër njihet sot, Ilir/ilirët.

Caloucianus
Calucones
Kalisia
Kousines

Ngjashmëria midis formave të këtyre fjalëve vihet re veçanërisht tek elementët:

***kin – *cian - *con – *si – *sin.**¹⁶ Tek këto forma vihet re ngjashmëria midis pjesës së dytë *sin të emrit Kousines me elementët përbërës të këtyre emërtimeve.

Krahasimi i emrit Kousines me emrat e këtyre fiseve, të cilët kanë në strukturën e formës së tyre gjuhësore bashkëtingëlloren *c = *k, ndërkohë që emri Kousines shfaqet me bashkëtingëlloren *s në përbërjen e tij, nuk e dëmton vlerën e këtij krahasimi, sepse brenda vetë këtij grupi emrash ata shfaqen këmbëveshëm me bashk. *s si tek emri Kalisia (sia) dhe me bashk. *k, si tek emrat e fiseve të tjerë, ku kemi format me *k të këtyre fjalëve: *kin, *kian, *kon. Aq më tepër që në gjuhësi njihet transformimi i bashkëtingëlloreve *k dhe *s, të cilat mund të zëvendësojnë njëra-tjetrën gjatë një procesi transformues. Elementët e ngjashëm të formave të këtyre emërtimeve do të paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

kin - cian – con - si - sin (lexo *c = *k)
(k*in - k*ian - k*on – s*i dhe s*in
i - ia – o - i - i

Krahasimi midis emrit Kousines dhe formave të këtyre emërtimeve na jep mundësinë të pranojmë që ka patur edhe forma të tjera të emrit Kousines, ku forma *sin e këtij emri, e cila është e ngjashme me formën *si të fisit Kalisia, të jetë shfaqur me zanoren *o (son), si tek emri i fisit ilir Calucones (con).

Nga ana tjetër larmia e formave të krijuara mbi të njëjtën rrënjë gjuhësore që ilirët kanë përdorur për të emërtuar vendet dhe vendbanimet e tyre, e cila vihet re edhe tek emërtimet e familjeve gjuhësore të sjella më lartë, na jep mundësinë të pranojmë që krahas emërtimit Kousines, ka patur edhe forma të tjera të kësaj fjale, të cilat kanë patur në rrënjën e tyre zanoren *o, ose zanoren *u. Fakte gjuhësore që mbështesin këtë pranim do të sillen në vijim të kësaj analize.

Si rrjedhojë e këtij arsyetimi është e pranueshme që forma e fjalës Kousines të ketë qënë forma më e hershme e emrit të sotëm Kosova, e cila është transformuar tek kjo formë me të cilën e shohim sot.¹⁷

Ngjashmëria e emrit Kousines me format e emrave të fiseve që u përmendën më lartë, si përshembull me formën e fisit Kaloikinos, si dhe larmia e formave me të cilat shfaqen emrat e këtyre fiseve të krijuara me rrënjën *cal/*kal na jep mundësinë të pranojmë që pranë emrit Kousines ka patur edhe emërtime të tjera të ngjashme me formën e emrit Kousines, të cilat do të kenë patur një formë të përafërt me format në vijim: *koston, *kuson, por edhe *kouson, të cilat janë transformuar tek forma e emrit të sotëm Kosova.

¹⁶ Elementët *cian dhe *con lexoju *kian dhe *kon, sepse bashk. *c e latinishtes lexohet tek këta emra si bashk. *k.

¹⁷ Procesi transformues nëpër të cilin ka kaluar emri Kosova dhe rruga e transformimit do të jetë objekt i trajtimit të pjesës së dytë të kësaj analize.

Forma *koson e supozuar më lartë do të ishte shumë e ngjashme me emrin e sotëm Kosovë. Tek emërtimet e sotme, siç do të vihet re edhe më poshtë, gjejmë një emërtim, i cili ka një formë fjale të ngjashme me formën *koson dhe njëkohësisht tregon ngjashmëri me emrin Kousines. Si shembull sjellim emrin e fshatit Kosin në Përmet, i cili dëshmon me formën e tij, që është një nga format e transformura të emrit Kousines, ose e një emri tjetër ilir, i cili ka patur në rrënjën e tij zanoren *o. Për emrin Kosin do të flitet më gjerësisht në një pikë tjetër të kësaj analize.

Në mënyrë të përmbledhur do të paraqiten edhe njëherë faktet e paraqitura më lartë: ilirishtja i njihë emërtimet e krijuara mbi bazën e rrënjës *kos, sepse emërtime ilire të krijuara me këtë rrënjë i gjejmë tek ato treva, të cilat në antikitet njihen si vendbanime ilire. Këto emërtime kanë qënë të pranishme edhe në Dardani dhe tregues për këtë është emri ilir Kousines. Emërtimet e së njëjtës familie gjuhësore shfaqen tek ilirishtja me forma të ndryshme, përkatësisht me zanoren *u, me zanoren *o dhe me togun zanor *ou këmbyeshëm. Rrënjët e emrave Kousines dhe Kosova tregojnë ngjashmëri në mënyrën e tyre fjalëformuese dhe ky fakt gjuhësor vendos lidhjen e drejtpërdrejtë midis emrit Kosova dhe emrave ilirë të antikitetit.

Mbi këtë bazë mund të pranojmë që pranë fjalës Kousines ka patur forma të tjera të kësaj fjale, të cilat janë shfaqur ose me zanoren *o, ose me zanoren *u, njëlloj si tek shembujt e familjes gjuhësore që përmendëm më lartë. Në vijim do të sjellim edhe dëshmi të tjera që provojnë këtë pranim gjuhësor.

Rëndësia e këtij përgjithësimi qëndron tek lidhja që vendoset midis emërtimit Kousines dhe emërtimit të sotëm Kosova, midis togut zanor *ou të rrënjës së fjalës Kousines dhe zanores *o të rrënjës së fjalës së sotme Kosova..

Rëndësia e këtij përgjithësimi qëndron tek lidhja që vendoset midis emërtimit Kousines dhe emërtimit të sotëm Kosova, midis togut zanor *ou të rrënjës së fjalës Kousines dhe zanores *o të rrënjës së fjalës së sotme Kosova. Kjo ngjashmëri midis këtyre dy fjalëve dhe kjo logjikë gjuhësore na jep mundësinë të pranojmë që emri Kosova e ka prejardhjen nga emri Kousines, ose nga një formë e ngjashme me këtë emërtim.

Mbi bazën e analizës së zhvilluar deri në këtë pikë është vendosur lidhja midis rrënjës *kos të formës së sotme të emrit Kosova me emërtimet ilire të krijuara me anë të kësaj rrënje. Një studim më i gjerë do të sillte një numër më të madh të emërtimeve ilire të krijuara me rrënjën *kos, pasi këtu janë sjellë vetëm disa përfaqësues të këtyre emërtimeve, të cilët kanë shërbyer si bazë krahasimi tek studimet e gjuhëtarëve gjermanë, për përcaktimin e emërtimeve ilire.

Si rrjedhim kemi mundësi të pranojmë që gjurmë të ekzistencës së emrit Kousines dhe të formave të tjera të ngjashme me këtë emërtim duhet ti gjejmë jo vetëm tek emri Kosova, por edhe tek emërtime të tjera të sotme. Fakt është, që tek emërtimet e sotme gjejmë emra, të cilët tregojnë ngjashmëri në mënyrën fjalëformimit me emrin ilir Kousines si dhe me emërtimet e tjera ilire që u përmendën më lartë.

Për këtë arsye, në vijim të kësaj analize do të bëhen krahasime jo vetëm midis emrit Kosova dhe emërtimeve ilire, por edhe midis emërtimeve të sotme dhe emërtimeve ilire, të cilat kanë ngjashmëri në mënyrën e tyre fjalëformuese me këto emërtime. Nëpërmjet këtij krahasimi trekëndor, midis emrit Kosova, emërtimeve të sotme dhe emërtimeve ilire të antikitetit, emri Kosova vendoset në një plan shumë të gjerë krahasues gjuhësor, i cili krijon një pamje të plotë gjuhësore, e cila nga ana e saj na jep mundësinë që të

nxjerrim informacione të plota gjuhësore, si të vetmet fakte që lejojnë përcaktimin e emrit Kosova tek fondi i ilirishte.

Megjithatë duhet të theksojmë që forma e fjalës Kosova ka kaluar nëpër një rrugë më të gjatë transformuese gjuhësore, deri sa ka marrë formën me të cilën ne e njohim sot, ose më saktë formën e shkruar me të cilën ky emër njihet sot. Ky proces transformues nëpër të cilën ka kaluar emri Kosova do të jetë objekt i trajtimit të pjesës së dytë të kësaj analize.

Emërtimet e vendeve të ndryshme me emrin Kosova

Ndër faktet më të rëndësishme që vërteton prejardhjen ilire të emrit Kosova është prania e emërtimeve me këtë emër në vende të ndryshme si dhe në vende largë nga ajo trevë që njihet sot me emrin Kosova. Pikërisht tek kjo dukuri janë mbështetur edhe gjuhëtarët e Gjuhësisë Krahasuese tek studimet e tyre mbi gjuhët e antikitetit që nuk flitëshin, për të përcaktuar përkatësinë e një emërtimi tek një gjuhë e caktuar.

Emrin Kosova e gjejmë si emërtim në Maqedoni, në Dalmaci, në Bosnjë si dhe në Shqipëri e Kosovë. Vetëm brenda kufijve të sotëm zyrtarë të Shqipërisë emri Kosova shfaqet 4 herë si emërtim: dy fshatra në rrethin e Lushnjës mbajnë emrat Kosovë e madhe dhe Kosovë e vogël, një fshat në Elbasan quhet po Kosovë dhe një fshat në Fierz, në rrethin e Pukës njihet po me emrin Kosovë. Tre nga këto emërtime ndodhen në ato vende, ku flitet dialekti i toskërishtes dhe dialekti i Shqipërisë së mesme.

Ky fakt tregon që emri Kosova ka qënë e njohur si fjalë emërtuese për atë popullsi, e cila e ka përdorur këtë fjalë për të emërtuar vende të ndryshme. Ky fakt paraprihet nga fakti tjetër, që ajo popullsi që i vendosi këto emërtime e kishte këtë fjalë, si dhe rrënjën e kësaj fjale në fondin e fjalëve emërtuese të gjuhës së saj, të cilën ajo e përdorte shpesh për të emërtuar ato vende, ku ajo kishte vendbanimet e saj.

Kjo mënyrë emërtuese përputhet plotësisht me traditën ilire të emërtimit, është dukuri tipike e artit ilir të emërtimit, e cila/i cili duket qartë tek shembujt e emërtimeve ilire të sjellë më lartë si dhe tek qindra shembuj të tjerë, të cilat i gjejmë tek të gjitha ato vende, të cilat njihen që nga antikiteti si vendbanime të fiseve ilire. Një numër të madh të këtyre shembujve i gjejmë tek studime të ndryshme gjuhësore mbi gjuhën ilire, të cilat mbështesin dhe vërtetojnë këtë traditë të emërtimit të fiseve ilire.

Përderisa gjejmë emërtime të krijuara me rrënjën *kos në vende largë nga Ballkani, në Gadishullin Apenin dhe akoma më tej në veri të Europës, logjika pranon që fiset ilire e kanë përdorur fjalën Kosova si dhe rrënjën *kos të kësaj fjale për të emërtuar edhe vende të ndryshme të vendbanimeve të saj. Ballkani njihet si vendbanimi fillestar i fiseve ilire, si të thuash ato ishin në këto treva në shtëpinë e vet, prandaj edhe emërtimet me emrin Kosova që gjenden në Maqedoni, Bosnjë dhe Dalmaci dhe aq më tepër emërtimet me këtë emër në Shqipëri dhe Kosovë, janë emërtime ilire, të cilat popujt e tjerë, i mësuuan nga fiset ilire të atyre trevave, kur ata erdhën në këto anë. Natyrisht që popujt e tjerë kanë zëvendësuar shumë emërtime ilire në Ballkan me emërtime të gjuhës së tyre, por emërtimi Kosova i përket atij grupi emërtimesh, të cilët kanë mbetur në përdorim nga periudha ilire. Faktet gjuhësore që mbështesin këtë pranim do të sillen në zhvillim të kësaj analize.

Fakti që emërtimi Kosova shfaqet edhe në Shqipëri si dhe fati që ky emër shfaqet si emërtim në ato vende, ku flitet dialekti i jugut mbështet plotësisht prejardhjen ilire të kësaj fjale emërtuese dhe dëshmon njëkohësisht që edhe emërtimet e tjera me këtë emër kudo që ato gjenden, në Bosnjë, në Maqedoni dhe në Dalmaci janë vendosur nga fiset ilire. Logjika që “Fusha e Kosovës” është emërtuar sipas emrit të një zogu, nuk justifikon praninë e këtij emërtimi në vende të ndryshme, ku nuk njihet prania e këtij zogu.

Logjika që ky emërtim është vendosur nga ajo popullsi, e cila kishte qënë banorja e vetme më e hershme e të gjithë këtyre trevave, ku shfaqen këto emërtime, që ajo popullsi i kishte emërtuar ato vende me emra specifike të gjuhës së saj, që ajo zgjidhte nga fondi i fjalëve emërtuese të gjuhës së saj, shpesh të njëjtat fjalë për të emërtuar vendet dhe vendbanimet e saj, që kjo mënyrë emërtuese përputhet plotësisht me traditën, mentalitetin dhe artin e saj të emërtimit, të cilin ajo e ka përdorur kudo, ku ka patur vendbanimet e saj, shembuj të të cilave i gjejmë tek një numër jashtëzakonisht të madh emërtimesh të antikitetit dhe të sotme, është plotësisht e pranueshme. Faktet gjuhësore që do të sillen në vazhdim të kësaj analize mbështesin dhe plotësojnë këtë logjikë të parashtruar më lartë, sepse ato janë të patjetërsueshme dhe provat më të sigurta për përcaktimin e një emërtimi tek një gjuhë e caktuar.

Ata janë tregues që popullsia, e cila përdori fjalë të njëjta si emërtime, për të emërtuar vendbanimet e saj, si në veri ashtu edhe në jug, të cilat i krijoi me të njëjtët elementë fjalëformues të gjuhës saj, si dhe përdori të njëjtën mënyrë fjalëformmi për krijimin e tyre, në përputhje me ligjet e brendshme të gjuhës që ajo fliste, ishte e njëjta popullsi, popullsia ilire, për të cilën ishin të njohura këto fjalë emërtuese dhe të cilat ajo i përdorte në mënyrë të përsëritur, kudo ku kishte vendbanimet e saj. Kjo analizë është e vlefshme për të gjitha emërtimet, të cilat gjenden në ato vende, ku fliten të dy dialektet. Në këtë mënyrë është vendosur edhe lidhja midis këtyre emërtimeve dhe përdoruesve të tyre.

Si përfundim mund të themi që të gjitha emërtimet me emrin Kosova, kudo ku këto emërtime shfaqen, janë vendosur nga fiset ilire, i përkasin periudhës ilire të emërtimit dhe kanë mbetur në përdorim nga ajo periudhë e historisë deri në ditët e sotme.

Emra të ngjashëm me emrin Kosova

Emërtimet e sotme të krijuara me rrënjët *kuç dhe *koç

Përveç emërtimeve me emrin Kosova, gjenden tek fondi i emërtimeve të sotme edhe disa emërtime, të cilat tingëllojnë njëllor si fjala Kosova. Njëri prej tyre është emri Kuçovë në rrethin e Beratit, i cili tingëllon njëllor me emrin Kosovë, po të zëvendësohet bashkëtingëllorja *ç me *s. Një emërtim të ngjashëm gjejmë edhe në Elbasan, i cili ka formën Kukuçovë dhe një emërtim tjetër po në rrethin e Elbasanit mban emrin Koshovë. Siç vihet re këta emra kanë jo vetëm tingëllim të njëjtë, por edhe mënyrë të njëjtë fjalëformimi si dhe elementë të njëjtë ose të ngjashëm fjalëformuese me emrin Kosovë.

Emri Kukuçovë është krijuar njëllor si emri i një fshati tjetër, po në rrethin e Elbasanit, i cili quhet Kukur. Të dy këto emërtime kanë në përbërjen e tyre të njëjtin element fjalëformues *ku në fillim të fjalës. Ky fakt gjuhësor është tregues që popullsia që i krijoi dhe vendosi këto emërtime, i njihte këta elementë fjalëformues dhe i përdorte ata për të krijuar emërtime të ndryshme me fjalë të gjuhës së saj, prandaj edhe fjalët e krijuara me këtë element fjalëformues, Kukur dhe Kukuçovë, i përkasin fondit të së njëjtës gjuhë, e cila është gjuha ilire. Analogjia e përshkruar më lartë mund të sqarohet më hollësisht në këtë mënyrë: emërtimi Kukur, i cili ka në përbërjen e tij elementin fjalëformuese *ku i përket fondit të shqipes, sepse ai tingëllon plotësisht si fjalë e shqipes dhe sepse gjejmë edhe emërtime të tjera, të cilat kanë në përbërjen e tyre elementin fjalëformues *kur, i cili gjithashtu është pjesë përbërëse e emrit Kukur si tek emërtimet: Kurjan, Kuratë, Kuraten, Kurdari, Kuritë, Kurtaj, Kurtës, Kurtinë, Kurillë, Kurbnesh, ... etj. Këto emërtime tregojnë që fjala *kur i përket fondit të shqipes, prandaj edhe emërtimi Kukur i përket po këtij fondi, pasi popullsia që e krijoi këtë emërtim i njihte këta dy elementë.

Si rrjedhim edhe fjala Kukuçovë, e cila ka si parashtesë elementin fjalëformues *ku është krijuar po nga e njëjta popullsi që krijoi emrin Kukur, sepse ajo njihte edhe elementin fjalëformues *ku edhe fjalën “Kur” edhe fjalën “Kuçovë”, të cilat i lidhi me njëra-tjetrën për të krijuar emërtime të reja. Rëndësi nga ana gjuhësore ka fakti që elementi *ku është përdorur si parashtesë e këtyre emërtimeve, pasi ky fakt gjuhësor përforcon prejardhjen vendase të këtyre emërtimeve, është tregues që këto emërtime janë krijuar nga popullsia ilire. Parashtesa e një fjale ka si premisë që krijuesit e fjalës së re njohin kuptimin e rrënjës së fjalës, ose më saktë, ata krijojnë një fjalë të re me fjalët e fondit të gjuhës së tyre. Kjo e dhënë dëshmon që edhe emri Kuçovë është një emërtim, i cili i përket fondit të shqipes. Për prejardhjen ilire të këtyre emërtimeve do të sillen fakte të tjera në vijim.

Përcaktimi i emrit Kuçovë tek fondi i shqipes, ka si rrjedhim që edhe emri Kosova, i cili është i ngjashëm me këtë emër, i përket për analogji fondit të shqipes. Për trashëgiminë e këtyre emërtimeve nga periudha ilire do të flitet më poshtë. Me këtë analizë është sjellë një prej dëshmive të shumta që tregojnë që emërtimi Kosovë është vendosur nga ato fise, të cilat i njihnin këto fjalë emërtuese dhe të cilat i përdorin për të emërtuar vende të ndryshme të vendbanimeve të tyre. Këto ishin fiset ilire dhe faktet gjuhësore për këtë do të sillen në vazhdim.

Dëshminë më të rëndësishme gjuhësore që përcakton karakterin vendas të emrit Kuçovë, pra prejardhjen e saj iliro-shqiptare, e sjell rrënja *kuç e kësaj fjale, mbi bazën e së cilës janë krijuar një numër i madh emrash fshatrash të shpërndarë gjithandej nëpër Shqipëri dhe Kosovë.

Numri i emërtimeve të krijuar mbi bazën e një rrënje si dhe shpërndarja gjeografike e këtyre emërtimeve, janë prova themelore dhe vërtetuese për përcaktimin e emërtimeve tek një gjuhë e caktuar, prandaj do të sillen në vijim emrat e fshatrave të krijuar mbi bazën e rrënjës *kuç:

Kuç në Berat, Kuç në Vlorë, Kuç në Tiranë, Kuç në Devoll, Kuç në Skrapar, Kuçi në Shkodër, si dhe emrat Kuçok në Durrës dhe Kuçak në Moglicë, në rrethin e Korçës. Emra të krijuar mbi bazën e kësaj rrënje takohen edhe në Kosovë, prej të cilëve përmendim emrin Kuçica në Skënderaj si dhe emrin e fshatit Kuçishti në Pejë.

Siç vihet re tek të gjitha këto emërtime, rrënja *kuç është përdorur si emërtim në formën e saj të thjeshtë. Emërtimet, të cilat shfaqen vetëm me rrënjën e fjalës përcaktohen direkt si emërtime ilire dhe si rrjedhim edhe emërtimet e krijuara mbi bazën e këtyre rrënjëve i përcaktohen fondit të ilirishtes. Kur forma e thjeshtë e fjalës përdoret si fjalë emërtuese është treguesi kryesor që këto emërtime i përkasin traditës ilire të emërtimit dhe si rrjedhim edhe periudhës ilire.

Kur një fjalë shfaqet si emërtim në formën e saj të thjeshtë tregon që popujt që përdorën këto forma të thjeshta të fjalëve për të emërtuar vendbanimet e tyre njihnin kuptimin e tyre. Përdorimi i një fjale në formën e saj të thjeshtë si fjalë emërtuese tregon që kemi të bëjmë me një emërtim të pastër vendas, me një emërtim ilir. Ky fakt është një nga dëshmitë më të rëndësishme gjuhësore që tregon përkatësinë e rrënjës *kuç dhe si rrjedhim edhe të fjalës Kuçovë tek fondi i gjuhës ilire dhe si rrjedhim edhe tek fondi i shqipes, si fjalë emërtuese e trashëguar nga ilirishtja.

Fakti që ky emërtim shfaqet në formën e tij të thjeshtë edhe tek ato vende, ku flitet dialekti i toskërishtes, është dëshmi tjetër gjuhësore, që tregon për karakterin mbarëgjuhësor të këtij emërtimi, sepse ajo ishte e njohur si fjalë emërtuese tek të dy dialektet e shqipes. Pikërisht karakteri mbarëgjuhësor që vihet re tek kjo fjalë, sjell informacione të tjera të rëndësishme gjuhësore edhe për karakterin vendas të emrit Kosova, të cilat do të analizohen në vijim.

Prejardhjen vendase të emërtimeve të krijuara me rrënjën *kuç e mbështet edhe një fakt tjetër gjuhësor: përveç rrënjës *kuç, e cila ka në përbërjen e saj zanoren *u, takojmë edhe formën *koç si rrënjë emërtuese, e cila ka në përbërjen e saj zanoren *o. Forma me zanoren *o e rrënjës *koç ka ngashmëri fjalëformuese me rrënjën *kos të emrit Kosovë, por ndryshe nga emri Kosovë, ajo ka në përbërjen e formës së saj gjuhësore bashkëtingëlloren *ç, në vend të bashkëtingëllores *s të emrit Kosovë.

Të dhënat gjuhësore që përcjell rrënja *koç në lidhje me fjalëformimin e formës saj gjuhësore sjellin informacione gjuhësore me vlerë edhe për rrënjën *kos, të cilat mund të përdoren këmbëveshëm për të dyja këto rrënjë fjalësh.

Bashkëtingëllorja *ç e rrënjëve *kuç dhe *koç është pasqyrim i transformimit të togut bashkëtingëllor *ts ose *tsh tek bashkëtingëllorja *ç. Togu bashkëtingëllor *ts/*st është një nga elementët tipik fjalëformues të emërtimeve ilire, i cili takohet tek një numër i madh emërtimesh të shpërndara nëpër Europë, në antikitetet dhe sot. Kudo që gjenden emërtime të krijuara me këtë element fjalëformues ato janë përcaktuar si emërtime ilire.

Forma më e hershme e rrënjës *koç do të ketë qënë “kotsh/t, ose *kots/*kost, të cilat janë transformuar në formën *koç. Të njëjtën gjë do të thoshim edhe për rrënjën *kuç si dhe për të gjitha emërtimet e tjera, të cilat kanë në përbërjen e tyre bashkëtingëlloren *ç. Pra kemi dy rrënjë fjalësh, të cilat kanë në përbërjen e tyre elementin fjalëformues *ts/*st të ilirishtes, prandaj edhe këto fjalë i përkasin fondit të kësaj gjuhe.

Edhe rrënja *koç takohet si emërtim në formën e saj të thjeshtë tek një numër i madh emërtimesh të shpërndara gjithandej nëpër Shqipëri. Si shembuj të këtyre emërtimeve sjellim emrat: Koçaj në Lushnjë, Koçaj në Elbasan, Koçaj në Tiranë, Koçaj në Bulqizë, Koci dhe Koçul në Vlorë, Koç-sheshaj në Kavajë si dhe emrat Koçanë dhe Koçanaj në Tropojë.

Fakti që fjala *koç, njëlloj si rrënja *kuç shfaqet në formën e saj të thjeshtë si emërtim është një nga treguesit themelor gjuhësor që dëshmojnë për prejardhjen ilire të këtyre rrënjëve. Rrënja *kos e fjalës Kosovë tregon ngjashmëri në mënyrën e fjalëformimit me rrënjën *koç, e cila është tipike për gjuhën ilire. Të dyja këto rrënjë *kos dhe *koç shfaqen me zanoren *o në formën e tyre gjuhësore dhe kanë në përbërjen e tyre një bashkëtingëllore frikative të formës *s ose *ç. Përcaktimi i emërtimeve të krijuara me rrënjën *koç tek fondi i shqipes, është dëshmi gjuhësor që tregon, që edhe rrënja e emrit *kos e emrit Kosova, plotësisht e ngjashme nga ana e fjalëformimit me rrënjën *koç, i përket për analogji fondit të shqipes. Fakte të tjera gjuhësore, të cilat do të dalin nga analiza në vazhdim do të mbështesin dhe plotësojnë këtë analogji gjuhësore.

Tek emërtimet e krijuara me rrënjët *kuç dhe *koç vihet re e njëta dukuri gjuhësore që karakterizon mënyrën e fjalëformimit të emërtimeve ilire, të cilat i përkasin së njëjtës familie gjuhësore, për të cilën u fol më lartë.

Tek rrënjët *koç dhe *kuç kemi dy forma fjalësh, të cilat kanë fjalëformim të njëjtë dhe shfaqen me zanoren *u dhe me zanoren *o. Kjo dukuri u vu re tek emërtimet ilire që i përkasin së njëjtë familie gjuhësore, si tek emërtimet Cosa dhe Apsos, të cilët shfaqen me zanoren *o, si dhe tek emërtimi Cusum, i cili shfaqet me zanoren *u.

Prania e kësaj dukurie ilire, e cila vihet re tek rrënjët e fjalëve emërtuese *kuç dhe *koç është një fakt gjuhësor që i përcakton këto rrënjë fjalësh tek fondi i ilirishtes dhe si rrjedhim edhe tek fondi i shqipes së sotme.

Ngjashmëria që vihet re midis rrënjës *koç dhe *kos të fjalës Kosova, janë dëshmi të mënyrës së fjalëformimit të ilirishtes, të cilën e gjejmë tek një numër i madh emërtimesh të tjera. Mënyra e fjalëformimit të ilirishtes është tregues gjuhësor që flet që këto fjalë janë krijime të gjuhës ilire, prandaj këto rrënjë i përkasin fondit të ilirishtes dhe si rrjedhim edhe emërtimet me këto rrënjë janë vendosur nga fiset ilire. Këto fakte gjuhësore do të analizohen gjerësisht dhe me shembuj të tjerë në vazhdim.

Këtu do të theksohet edhe njëherë fakti i ngjashmërisë që rrënjët *koç dhe *kos tregojnë në mënyrën e tyre fjalëformuese, sepse ky fakt është një element gjuhësor thelbësor, që dëshmon që fjala Kosova nuk është fjalë e huazuar: nëse fjala Kosova do të kishte qënë fjalë e huazuar, atëherë nuk do të kishte patur forma të tjera të ngjashme me rrënjën e kësaj fjale, ose më saktë, nuk do të kishte patur rrënjë të tjera fjalësh, të cilat do të kishin fjalëformim të njëjtë me rrënjën *kos.

Ekzistenca e këtyre formave të ngjashme nga ana fjalëformimit flet për një dukuri gjuhësore, e cila lidhet me karakteristikat e fjalëformimit të një gjuhe. Mënyra fjalëformuese e një gjuhe është nga ato karakteristika të gjuhës, e cila nuk mund të huazohet nga një gjuhë tjetër dhe që e bën të dallueshme një gjuhë nga gjuhët e tjera, është kufiri ndarës midis gjuhëve, të cilat nuk lejojnë elementë të huaj të integrohen tek kjo mënyrë fjalëformuese.

Pikërisht kjo karakteristikë e gjuhës ilire, e cila karakterizon rrënjën *kos të emrit Kosova, është nga ato fakte gjuhësore, të cilat vërtetojnë prejardhjen ilire të kësaj fjale. Analiza e shembujve të tjerë që do të sillen në vijim do të mbështet këtë mënyrë të veçantë fjalëformuese të gjuhës ilire, e cila pasqyrohet tek rrënja *kos dhe kjo mënyrë fjalëformuese është treguesi gjuhësor që këtë fjalë janë trashëguar nga gjuha ilire.

Tingëllimi i fjalës Kosova

Një karakteristikë tjetër që mbështet prejardhjen ilire të emrit Kosova është tingëllimi i njëjtë i saj me emërtimet Kuçovë, Kushovë dhe Kukuçovë. Përveç këtyre emërtimeve takohen në viset e banuara nga shqiptarët edhe emërtime të tjera, të cilat kanë tingëllim të njëjtë me emrin Kosova dhe të cilat do të analizohen gjerësisht në pjesën e dytë të kësaj analize.

Ekzistenca e emërtimeve, të cilat tingëllojnë njëllor si fjala Kosovë është një nga treguesit më të rëndësishëm gjuhësor, që tregon që emri Kosova i përket gjuhës ilire.

Nëse fjala Kosovë do të kishte qënë fjalë e huazuar, atëherë ajo do të ishte shfaqur e vetme, me formën me të cilën do të ishte huazuar nga gjuha tjetër dhe nuk do të kishte patur emërtime të tjera të ngjashme me të, aq më tepër nuk do të kishte patur emërtime të tjera që të tingëllonin njëllor me këtë fjalë.

Tingëllimi i fjalëve të një gjuhe ka të bëjë me muzikalitetin e gjuhës dhe muzikaliteti është elementi që i jep jetë dhe formë një gjuhe, është treguesi themelor i identitetit të saj dhe i parë nga një këndvështrim tjetër është treguesi i vetëm që përbën bazën e ekzistencës së një gjuhe. Një fjalë mund të huazohet nga një gjuhë tjetër, por jo muzikaliteti i gjuhës.

Emërtimet Kuçovë, Kukuçovë, Koshovë, ... etj i përkasin gjuhës ilire, duke u mbështetur tek faktet që u përmendën më lartë. Krijuesit e këtyre emërtimeve, i krijuan ato në përshtatje me muzikalitetin e gjuhës së tyre, sepse folësit e një gjuhe krijojnë fjalë emërtuese në përputhje me muzikalitetin e gjuhës së tyre, dhe jo të një gjuhe të huaj. Nga ana tjetër këto emërtime kanë tingëllim të njëjtë me emrin Kosova.

Tingëllimi i njëjtë që fjala Kosova ka me këto fjalë emërtuese tregon që edhe ajo i përket po asaj gjuhe që i përkasin këto emërtime. Tingëllimi i njëjtë i të gjitha këtyre fjalëve tregon që të gjitha këto emërtime vijnë nga e njëjta gjuhë dhe kanë të njëjtët krijues. Fiset ilire që krijuan emërtimet Kuçovë dhe Kushovë me tingëllimin e gjuhës së tyre janë edhe krijuesit e fjalës Kosova, e cila tingëllon njëllor si këto fjalë.

Nëse emri Kosova do të ishte emërtim i huazuar, atëherë nuk do të kishte patur emërtime të tjera që do të tingëllonin njëloj me këtë emër, nuk do të krijonin emërtime me tingëllimin e fjalës së një gjuhe të huaj.

Numri i emërtimeve që kanë tingëllim të njëjtë me fjalën Kosova është më i madh. Edhe numri i tyre është një tregues që dëshmon që këto emërtime i përkasin së njëjtës gjuhë, sepse ai tregon që nuk kemi të bëjmë me një shfaqje të vetme, të rastësishme, me tingëllimin e një fjale të vetme, të fjalës Kosova, por me një numër të konsiderueshëm emërtimeve, të cilët i përshtaten muzikalitetit të gjuhës së emërtuesve.

Kjo dëshmi bën pjesë tek ato fakte gjuhësore, të cilat vërtetojnë dhe lejonë plotësisht që emri Kosova ti përcaktohet direkt fondit të ilirishtes.

Në mënyrë të përmbledhur do të paraqiten edhe njëherë faktet e nxjerra nga analiza më lartë: të gjitha emërtimet e përmendura tek kjo nëntemë janë krijime ilire, sepse ato tregojnë mënyrë të njëjtë fjalëformimi, e cila është e njëjtë me mënyrën fjalëformuese të gjuhës ilire dhe sepse këto fjalë kanë tingëllim të njëjtë me njëra-tjetrën dhe si rrjedhim i përshtaten muzikalitetit të gjuhës së cilës ato i përkasin, ilirishtes.

Prejardhja ilire e rrënjës *kos të fjalës Kosova

Emërtimet me rrënjët fjalëformuese *kos dhe *kus

Përveç emërtimeve të krijuara me rrënjët *koç dhe *kuç gjenden tek fondi i emërtimeve të sotme edhe një numër emërtimeve të krijuara me rrënjën *kos, të cilat i përgjigjen plotësisht rrënjës *kos të emrit Kosovë. Për të plotësuar këtë pamje nga ana gjuhësore do të përmenden edhe emërtimet e krijuara me rrënjën *kus, sepse lidhja midis këtyre dy rrënjëve fjalëformuese përcjell informacione të rëndësishme gjuhësore prejardhjen gjuhësore të emrit Kosova.

Tek kjo pjesë e analizës vëmendja do të drejtohet tek emërtimet e sotme, të cilat janë krijuar me anën e rrënjës *kos njëloj si emri Kosova. Njëkohësisht do të tërhiqen në këtë analizë krahasuese edhe ato rrënjë fjalësh, të cilat kanë ngjashmëri nga ana e fjalëformimit me rrënjën *kos dhe bëjnë pjesë në të njëjtën familje gjuhësore me këtë rrënjë, sepse kjo analizë na përcjell informacione të rëndësishme gjuhësore mbi përkatësinë gjuhësore të emrit Kosova.

Numri i këtyre emërtimeve, format e tyre gjuhësore, larmia e formave me të cilat ato shfaqen, shpërndarja e tyre gjeografike, viset ku ato shfaqen, si dhe fakti i pranisë së tyre, i ekzistencës së tyre deri në ditët e sotme, na përcjell ato të dhëna, të cilat dëshmojnë mbi lidhjen e tyre me emërtimet ilire të antikiteti dhe sjellin ato fakte gjuhësore, të cilat lejojnë të bëhen përgjithësime dhe të arrihet në përfundime të mbështetura mbi bazën e fakteve.

Në vazhdim do të paraqitet një listë e emërtimeve të sotme të krijuara mbi bazën e rrënjëve *kos dhe *kus, e cila do të shërbej si bazë për analizën krahasuese të këtyre emërtimeve me emërtimet ilire.

Prej emërtimeve të krijuar me rrënjën *kos përmendim emrat:

Kosin në Përmet, Kostar në Delvinë, Kostur në Has/Pukë, Kosmaçi në Shkodër, Kostar në Delvinë, Kostren i madh dhe i vogël në Berat, Kostenjë në Librazhd si dhe emërtimet Kosava, Kostërca, Kosuriqi, Kostinpotoku dhe emrin Kosaçi në Kosovë.

Do të përmendim në këtë grup edhe emërtimet e krijuara me rrënjën *koz dhe me rrënjën *koc, sepse këto forma fjalësh tregojnë ngjashmëri në mënyrën fjalëformimit me rrënjën *kos, dhe sepse ato kanë në përbërjen e tyre zanoren *o. Format gjuhësore *koz dhe *koc shfaqen përkatësisht me bashkëtingëlloret *z dhe *c në vend të bashkëtingëllores *s të rrënjës *kos. Bashkëtingëlloret *s, *z dhe *c bëjnë pjesë në grupin e bashkëtingëlloreve frikative, të cilat gjatë një procesi transformues të fjalës mund të zëvendësojnë njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që bashkëtingëlloret *s mund të transformohet në bashk. *z dhe *c, por edhe në një bashkëtingëllore tjetër frikative. Ky proces transformues i bashkëtingëllores *s është i njohur në gjuhësi.

Prej emërtimeve të krijuar me rrënjën *koz përmendim emrat: Kozan në Elbasan, Kozare në Lushnje, Shkozë në Tiranë, Shkozë në Vlorë, Shkozë në Pukë dhe Shkozë në Belsh, si dhe emërtimet Shkoza në Korçë, Shkozet në Durrës, Shkohanji në Korçë, Kozeli në Kolonjë dhe për efekt krahasimi përmendim edhe emërtimin Kozhnja në Kelmend, e cila ka në përbërjen e saj bashkëtingëlloren frikative *zh.

Prej emërtimeve të krijuar me rrënjën *koc përmendim emrat: Koci, Koculi, Drekoci, Brekoci, Makoci, Likoci, Leskoci, Nekoci, Nedakoci, Nikoci, Gjurkoci, ... etj.

Prej emërtimeve të krijuara me rrënjën *kus përmendim emrat e dy fshatrave në rrethin e Tiranës, të cilët njihen me emrin Kus, emërtimin Kusbaba në Vlorë, emrin Kusarth në Elbasan si dhe emrin Gusmar në Tepelenë. Nga Kosova përmendim emrat e fshatrave Kusari në Gjakovë, Kuzmini në fushë Kosovë, Kozarica në komunën e Kelmendit.

Tek materiali i emërtimeve që u soll më lartë vihen re disa karakteristika gjuhësore, të cilat përcjellin informacione të rëndësishme dhe përcaktuese në lidhje me emrin Kosva dhe prejardhjen e tij.

Karakteristika e parë që vihet re tek emërtimet e sjella më lartë, janë emërtimet e krijuara me rrënjën e fjalës, pra me formën më të thjeshtë të fjalës, si tek emrat e dy fshatrave në rrethin e Tiranës, të cilët mbajnë emrin Kus. Siç u përmend edhe më lartë, emërtimet, të cilat shfaqen vetëm me rrënjën e fjalës përcaktohen direkt si emërtime ilire dhe si rrjedhim edhe emërtimet e krijuara mbi bazën e këtyre rrënjëve i përcaktohen fondit të ilirishtes. sepse përdorimi i një fjale në formën e saj më të thjeshtë si emërtim është karakteristikë e veçantë e traditës ilire të emërtimit. Kur një fjalë shfaqet si emërtim në formën e saj të thjeshtë tregon që popujt që përdorën këto forma të thjeshta të fjalëve për të emërtuar vendbanimet e tyre njihnin kuptimin e tyre.

Nëse fjala Kosova do të kishte qenë fjalë e huazuar, atëherë kjo fjalë do të shfaqej vetëm në atë formë që do të ishte huazuar nga gjuha tjetër dhe rrënja e kësaj fjale *kos, nuk do të përdorej si emërtim në formën e saj të thjeshtë. Forma e thjeshtë e kësaj fjale nuk do të shfaqej si emërtim i vendeve të ndryshme dhe akoma më tej nuk do të shfaqej si emërtim në vende të tjera largë nga Kosova, por do të ishte vetëm emërtimi i një fushe, i *Fushës së Kosovës”.

Përdorimi i këtyre fjalëve *kos dhe *kus në formën e tyre të thjeshtë si emërtim është një karakteristikë e veçantë e traditës emërtuese ilire. Emërtimet me rrënjën e fjalës, janë tregues që këto emërtime i përkasin periudhës ilire, të cilat kanë mbetur në përdorim në atë formë deri në ditët e sotme. Kjo karakteristikë e emërtimeve të krijuara me rrënjët *kos dhe *kus është një prej dëshmimeve gjuhësore, që vendos lidhjen midis këtyre emërtimeve dhe emërtimeve ilire të antikitetit.

Një karakteristikë tjetër që vihet re tek emërtimet e paraqitura më lartë është larmia e formave të emërtimeve të krijuara mbi bazën e rrënjëve *kos, *koz, *kus dhe *koc, si dhe larmia e elementëve fjalëformues me të cilët janë krijuar format e ndryshme të këtyre emërtimeve. Këta tregues gjuhësorë dëshmojnë që këto emërtime i përkasin periudhës ilire: elementët fjalëformues të këtyre emërtimeve janë të njohura në gjuhësi si element fjalëformues të ilirishtes: bëhet fjalë për para,- dhe prapashtesat e fjalëve emërtuese si dhe për mbaresat e tyre. Përcaktimi i tyre si element fjalëformues të ilirishtes nga Gjuhësia Krahasuese është mbështetur tek fakti që ata takohen shpesh tek emërtimet ilire të antikitetit.

Njëri prej këtyre elementëve është prapashtesa *an, të cilën e gjejmë si tek emërtimet ilire të antikitetit ashtu dhe tek emërtimet e sotme tek të cilët ajo shfaqet edhe si parashtesë dhe si prapashtesë.

Prej emërtimeve ilire të krijuara me këtë element fjalëformues përmendim emrat Athamanes, Atintanes, Eurytanes, Azanes, Ainianes, ... etj. Nga numri i madh i emërtimeve ilire të krijuara me prapashtesën *an u zgjodhën pikërisht këto emërtime, sepse ato janë përcaktuar nga gjuhëtarët e Gjuhësisë Krahasuese edhe si emërtime ilire edhe si emërtime pellazge.¹⁸

Siç u vu në dukje edhe më lartë prapashtesën *an të ilirishtes e gjejmë edhe tek një numër i madh i emërtimeve të sotme, por këtu do të përmendim disa emërtime të krijuar me rrënjën *kos, të cilat kanë në përbërjen e tyre elementin fjalëformues *an, si emërtimin Kozan (koz + an) dhe Shkozanj (sh + koz + an/j).

Përveç emërtimeve të krijuar me prapashtesën *an, gjejmë edhe emërtime të krijuara me prapashtesën *in, si emërtimin Kosin (kos + in). Emrat Kosin dhe Kozan kanë ngjashmëri në mënyrën e fjalëformimit dhe kanë në përbërjen e tyre prapashtesa, të cilat i përkasin fondit të ilirishtes. Me prapashtesën *in janë krijuar edhe disa emërtime të tjera të ngjashme me emërtimin Kosin, si emërtimet Kostin, Kostlina si dhe Kostinpotoku (kost + in + potoku). Për krahasim përmendim edhe emërtimet Kostenjë dhe Kostren, të cilët kanë të njëjtën mënyrë fjalëformimi me emërtimet e përmendura më lartë, ndërsa kanë në përbërjen e tyre prapashtesën *en. Të gjitha këto prapashtesa *an, *in, *en takohen edhe tek emërtimet ilire, prandaj ato janë përcaktuar si elementë të ilirishtes.

Elementë të tjerë fjalëformues të ilirishtes, si p.sh. elementët *ar, *ur, *or, të cilët takohen në përbërjen e emërtimeve të sotme të krijuar me anë të rrënjëve *kos dhe *kus, do të analizohen më gjerësisht tek një nëntemë tjetër në vijim të kësaj analize.

Prania e elementëve fjalëformues të ilirishtes tek emërtimet e krijuara me rrënjët *kos dhe *koz janë dëshmi tjetër gjuhësore që tregojnë që këto emërtime i përkasin periudhës ilire të emërtimeve. Edhe sikur ndonjë prej këtyre emërtimeve të jetë krijuar në periudhën e shqipes, atëherë elementët fjalëformues të ilirishtes në përbërjen e tij do të dëshmonin që shqipja ka trashëguar nga ilirishtja edhe elementët fjalëformues, edhe artin, edhe traditën e saj të emërtimit.

Në këtë pikë të analizës është me rëndësi të theksohet edhe njëherë fakti që rrënja *kos shfaqet tek emërtimet e sotme e lidhur me elementë fjalëformues të ilirishtes dhe ky fakt gjuhësor e lidh këtë rrënjë me emërtimet ilire dhe me gjuhën ilire.

18 Duke u mbështetur tek këto emërtime dhe tek një numër jashtëzakonisht i madh emërtimeve të tjera, të cilat u analizuan nga ana gjuhësore, mbi bazën e kriterëve rigorozë gjuhësore si dhe duke u mbështetur edhe tek të dhëna të fushave të ndryshme, gjuhëtarët gjermanë kanë vendosur lidhjen midis fiseve ilire dhe fiseve pellazge, midis gjuhës ilire dhe gjuhës pellazge dhe kanë arritur në përfundimin që kemi të bëjmë me të njëjtën gjuhë dhe me popuj të njëjtë, të cilët i përkasin së njëjtës etni dhe si rrjedhim është vendosur edhe lidhja midis ilirishtes, pellazgjishtes dhe shqipes së sotme.

Nëse emri Kosova do të kishte qënë emër i huazuar, atëherë rrënja *kos e kësaj fjale, do të shfaqej vetëm tek kjo fjalë dhe vetëm në këtë formë, por jo tek emërtime të tjera dhe jo e lidhur me elementë fjalëformues të ilirishtes dhe akoma më tej jo në atë larmi formash me të cilat ajo shfaqet tek emërtime të ndryshme.

Larmia e formave të emërtimeve me të cilat shfaqen rrënjët *kos dhe *kus është një tregues tjetër gjuhësor që dëshmon për prejardhjen ilire të fjalës Kosova. Ajo tregon që këto rrënjë fjalësh ishin të njohura si fjalë emërtuese për krijuesit e këtyre emërtimeve, tregon që ata i kanë patur në përdorim të vazhdueshëm këto rrënjë dhe elementët e tyre fjalëformues dhe që ata i zgjidhnin ato shpesh nga fondi i fjalëve emërtuese të gjuhës së tyre, i bashkonin me elementë dhe fjalës të ndryshme të gjuhës së tyre dhe krijonin me to forma të ndryshme emërtimesh për të emërtuar vendbanimet e tyre. Prandaj edhe larmia e formave të emërtimeve është dëshmi gjuhësore që tregon që këto rrënjë fjalësh i përkasin fondit të ilirishtes, sepse ato të japin përshtypjen sikur lulëzojnë brenda gjuhës ilire, ndërkohë që fjalët e huazara nuk gjejnë këtë lloj përdorimi të zgjeruar tek një gjuhë të huaj.

Fakti që rrënjën *kos, si dhe format e tjera të ngjashme me të *koz dhe *koc, i gjejmë tek emërtime të ndryshme, të lidhur me elementë të ndryshëm fjalëformues, të cilët i përkasin fondit të ilirishtes, fakti që kemi një larmi formash të emërtimeve të krijuara me këto rrënjë dëshmojnë që edhe fjala Kosova nuk kemi të bëjmë me një fjalë të huazuar, por me një fjalë që i përket fondit të ilirishtes, ashtu sikurse edhe rrënja e saj.

Karakteristika të tjera të këtyre emërtimeve

Tek materiali i emërtimeve të sjellë më lartë vihen re edhe tre veçori të rëndësishme, të cilat karakterizojnë emërtimet e krijuara me rrënjët *kos dhe *kus, si dhe format e tjera *koz dhe *koc. Këto veçori janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën prandaj ato do të analizohen së bashku.

Njëra prej këtyre veçorive lidhet me numrin e emërtimeve të krijuar me këto rrënjë. Fakti që rrënjën *kos dhe format e tjera të ngjashme me të i gjejmë tek një numër i madh emërtimesh, tregon që fiset ilire e kanë zgjedhur shpesh këtë rrënjë fjale për të emërtuar vende të ndryshme tek viset, ku ata kishin vendbanimet e tyre.

Nëse emri Kosova do të kishte qënë emër i huazuar, atëherë rrënja *kos e kësaj fjale do të shfaqej vetëm tek ky emër, dhe tek një emërtim i vetëm, por nuk do të kishte një numër të madh emërtimesh të krijuar me rrënjën e kësaj fjale.

Fakti i zgjedhjes së një fjale, apo të rrënje fjale për të emërtuar vende të ndryshme paraprihet nga preferenca e zgjedhjes, e cila nga ana e saj flet për domethënien dhe rëndësishtë që kjo fjalë kishte për fiset ilire si fjalë emërtuese, aq më tepër, kur bëhej fjalë për emërtimin e një vendbanimi, për të cilin ata zgjidhnin ato fjalë emërtuese, të cilat ishin të njohura për ta dhe kishin kutpim, si dhe i përdornin shpesh si fjalë emërtuese, në përputhje me traditën dhe mentalitetin e tyre të emërtimit.

Nëse ilirët emërtuan një numër të madh vendesh me emërtime të krijuara me rrënjën *kos, atëherë është plotësisht e logjikshme që të pranohet që ata emërtuan me emrin Kosovë edhe vende të ndryshme, të vendbanimeve të tyre.

Një veçorti tjetër që karakterizon emërtimet e krijuara me rrënjën *kos dhe format e tjera të ngjashme me të lidhet me shpërndarjen e gjeografike të këtyre emërtimeve, të cilat i gjejmë si emërtime në vise të ndryshme, shpesh largë nga ajo trevë që sot njihet me emrin Kosova. Këto fjalë emërtuese i gjejmë si emërtime të atyre vendeve, ku flitet dialekti i veriut, gegërishtja, ashtu edhe tek ato vende, ku flitet dialekti i jugut, toskërishtja dhe me të njëjtin intesitet shpërndarje dhe shfaqje.

Nëse emri Kosova do të kishte qënë emër i huazuar, atëherë rrënja *kos e kësaj fjale dhe format e tjera të ngjashme me të, do të shfaqej vetëm tek ky emër dhe vetëm si emërtim i një vendi me formën e kësaj fjale, por nuk do të shfaqej në përbërjen e emërtimeve largë nga Kosova dhe mbi të gjitha nuk do të ishte shfaqur tek emërtimet e vendeve, ku flitet dialekti i jugut.

Shpërndarja gjeografike e një emërtimi luan një rol të rëndësishëm për përcaktimin e tij tek një gjuhë e caktuar, sepse ai dëshmon që kemi të bëjmë me të njëjtën popullsi kudo, ku shfaqet ky emërtim, e cila i emërton vendbanimet e saj me ato fjalë të gjuhës së saj, të cilat kanë kuptim për atë dhe në përputhje me mentalitetin dhe traditën e saj të emërtimit. Fakti që rrënjën *kos e gjejmë si emërtim në vende të ndryshme, tregon që ajo është përdorur nga e njëjta popullsi, kudo ku ajo shfaqet si emërtim.

Fakti që emërtimet e krijuara me rrënjën *kos dhe formave të ngjashme me të, i gjejmë si emërtime të vendeve, ku fliten të dy dialektet e shqipes, tregon që këto rrënjë fjalësh kanë qënë pjesë e fondit të përbashkët të gjuhës ilire – pra rrënja *kos ka qënë një fjalë emërtuese mbarëgjuhësore, e njohur si fjalë emërtuese tek të dy dialektet.

Prania e këtyre emërtimeve tek të dy dialektet e shqipes është tregues i rëndësishëm gjuhësor, sepse dëshmon që kemi të bëjmë me elementë fjalëformues mbarëgjuhësor të një gjuhe si dhe me mënyrë fjalëformimi, e cila i përket po asaj gjuhe, ku bëjnë pjesë edhe këta elementë fjalëformues dhe si rrjedhim kemi të bëjmë me të njëjtën popullsi, e cila fliste po këtë gjuhë dhe përdorte elementët e gjuhës së saj si emërtime të vendbanimeve të saj, kudo që ajo ishte e pranishme.

Përdorimi i shpeshtë i kësaj rrënje si fjalë emërtuese të çon pashmagshmërisht tek ideja që kjo fjalë duhet të ketë patur një domethënie të veçantë për fiset ilire, të cilët e kanë përdorur atë shpesh si fjalë emërtuese të vendbanimeve të tyre. Kjo ide do të bëhet objekt i trajtimit të një analize tjetër, e cila do të trajtojë etimologjinë e kuptimit të kësaj fjale.

Analiza gjuhësore krahasuese e rrënjëve *kos dhe *kus ka rëndësi të veçantë për këtë temë që po trajtojmë, sepse këto rrënjë ruajnë në vetvete ato tipare gjuhësore, të cilat vendosin urën lidhëse kohore midis emërtimeve të sotme dhe emërtimeve ilire të antikitetit të krijuara me këto rrënjë. Këto emërtime ruajnë në strukturën e fjalës, tek mënyra e fjalëformimit dhe elementët fjalëformues të tyre, ato fakte gjuhësore, të cilat dëshmojnë që ato i përkasin periudhës ilire dhe kanë mbetur në përdorim prej asaj periudhe deri në ditët e sotme. Analiza krahasuese gjuhësore e këtyre rrënjëve bën të mundur që të hidhet dritë mbi këto fakte gjuhësore ekzistuese, të cilat janë baza e të dhënave gjuhësore që provojnë dhe vërtetojnë përkatësinë emrit Kosova tek gjuha ilire.

Faktet gjuhësore që u sollën më lartë vendosin urën lidhëse midis emërtimeve të sotme të krijuara me rrënjët *kos dhe *kus dhe emërtimeve të antikitetit. Këto fakte do të plotësohen me të dhëna, dëshmi dhe fakte të tjera tek analiza në vazhdim, të cilat i mbështesin dhe njëkohësisht zgjerojnë informacionet e tyre dëshmuese dhe vërtetuese.

Në këtë pikë të analizës do të theksojmë edhe njëherë përgjithësimin, që nga analiza e deritanishme, të gjitha faktet flasin, që rrënja *kos, e cila është në përbërjen e fjalës Kosova, i përket fondit të ilirishtes dhe si rrjedhim i përket këtij fondi edhe fjala Kosova.

Paraqitje e përmbledhur e fakteve të analizuara tek kjo nëntemë

Analiza e kësaj nënteme do të paraqitet në mënyrë të përmbledhur si në vijim: lidhjen e rrënjëve *kos dhe *kus me elementë të njohur fjalëformues të ilirishtes, shpërndarja e tyre gjeografike si në veri dhe në jug, prania e tyre tek të dyja dialektet gegërishtja dhe toskërishtja, numri i madh i emërtimeve të krijuar me këto rrënjë fjalësh, larmia e formave me të cilat ato shfaqen tek emërtime të ndryshme në lidhje me elementë fjalëformues të ilirishtes, emërtimet me format e thjeshta të këtyre rrënjëve, vendos lidhjen e drejtpërdrejtë të emërtimeve me rrënjën *kos dhe *kus që takojmë sot në Shqipëri dhe Kosovë me emërtimet ilire të antikitetit. Ato bëhen dëshmi e vazhdimësisë ilire në hapësirat ku jetojnë sot shqiptarët, në gjuhën dhe forlmen e të cilëve këto emërtime do të vazhdojnë të jetojnë dhe përdorën pandërprerë me ato forma që u krijuan sipas kësaj tradite, e cila do të përdorte fjalë dhe elementë të gjuhës së saj për ti emërtuar këto vende. Fakti që këto rrënjë, këto emërtime janë vazhdimësi e emërtimeve ilire janë njëkohësisht edhe prova të sigurta gjuhësore që vërtetojnë prejardhjen ilire të emrit Kosova.

Emërtimet kompozitë

Një dëshmi tjetër gjuhësore që flet për prejardhjen ilire të rrënjëve *kos dhe *kus si dhe të emërtimeve të krijuara me anë të tyre janë kompozitat që këto rrënjë fjalësh krijojnë me fjalë të tjera. Emërtimet kompozitë krijohen nga bashkimi i dy dhe më shumë fjalëve të një gjuhe, e cila ruan në vetvete kuptimet dhe nuancat ngjyruese të kuptimeve të të dy fjalëve fillestarë.

Krijimi i emërtimeve kompozitë ka si premisë që krijuesit e këtyre emërtimeve zgjedhin fjalë nga fondi i gjuhës së tyre, kuptimin e të cilave ata e njohin dhe i lidhin ato me njëra-tjetrën me një qëllim të caktuar, për shembull për të shprehur një kuptim të ri, ose një nuancë të re kuptimore, për të theksuar intensitetin e kuptimit fillestar të njërës prej fjalëve fjalëformuese, apo të të dyja fjalëve, të cilat ata i bashkuan për krijimin e fjalës së re. Emërtimet kompozitë të japin mundësinë që të përcaktosh prejardhjen gjuhësore të fjalëve përbërëse, kur njihet kuptimi i njërës fjalëve të kompozitës. Gjuhëtarët që u morën me studimin e gjuhës ilire kanë vënë në dukje që Ilirishtja ka një prirje të theksuar për të krijuar kompozita më shumë se latinishtja.

Tek materiali i emërtimeve të sjella më lartë kompozitat i gjejmë tek emërtimet e ngjashme Kusarth në Elbasan si dhe Kusari në Kosovë, tek emërtimet Kosmaçi në Shkodër dhe Kosaçi në Kosovë.

Emri Kusari nuk mund të përcaktohet plotësisht nëse është një emërtim kompozitë i krijuar nga dy fjalë të ndryshme *kus dhe *ari, apo nëse është një emërtim i krijuar me anë të rrënjës *kus dhe prapashtesës *ar/(i), megjithatë për efekt krahasimi do të pranohen të dyja mundësitë, sepse për këtë analizë do të përdorej në të dy rastet e njëjta logjikë krahasuese gjuhësore, me ndryshimin që do të kishim terma të ndryshme të përcatimit të elementit *ar/i, i cili ose do të emërtohej “elementi fjalëformues *ar” nëse do të ishte prapashtesë, ose do të emërtohej “fjala *ari”, nëse do të ishte fjalë që kishte krijuar një emërtim kompozitë. Pranimi që elementi *ari është fjalë kompozuese e mbështesin edhe disa emërtime kompozitë, si dhe emërtime të thjeshta, ku kjo fjalë shfaqet si fjalë përbërëse e tyre, të cilat tregojnë të njëjtën mënyrë fjalëformuese me kompozitën Kusari, si emërtimet Lugari, Lliari, Bubari, Kurdari, Buzarisht, por edhe emërtimet Brari Lavdari etj.

Le të shikojmë fillimisht emërtimin kompozitë Kusarth, i cili është krijuar nga bashkimi i fjalëve *kus dhe *arth. Krijuesit e këtij emërtimi njihnin kuptimin e të dyja fjalëve, prandaj i lidhën ato me njëra-tjetrën, për të krijuar një formë të re emërtimi, ndoshta për të theksuar kuptimin fillestar të njërës prej fjalëve, ose të të dyja fjalëve ... etj. Për këtë analizë ka rëndësi kuptimi gjuhësor i lidhjes në kompozitë të këtyre dy fjalëve dhe jo kuptimi semantik i të gjithë kompozitës: nëse njohim prejardhjen gjuhësore të njërës prej fjalëve të kompozitës, për shembull të fjalës *arth, atëherë kemi mundësi të përcaktojmë edhe prejardhjen gjuhësore të fjalës *kus me të cilën ajo ka krijuar kompozitë.

Fjala *arth ka në përbërjen e saj elementin fjalëformues *ar, i cili është përcaktuar si element tipik i ilirishtes, pasi ai takohet tek një numër i madh emërtimeve ilire të antikitetit, prandaj fjala *arth i përcaktohet direkt fondit të ilirishtes. Si rrjedhim edhe fjala *kus i përket fondit të ilirishtes, sepse krijuesit e kësaj kompozite i zgjedhën të dyja këto fjalë nga fondi i gjuhës së tyre.

Një tregues tjetër që mbështet plotësisht prejardhjen ilire të rrënjës *kus është fakti që elementin *arth e gjejmë të përdoret si emërtim në formën e tij të thjeshtë, si përshebull tek emri i fshatit Arthi në komunën e Lurës. Përdorimi i kësaj fjale në formën e saj të thjeshtë si emërtim, tregon që ajo i përket fondit të fjalëve emërtuese të gjuhës ilire, njëjloj si fjala *kus dhe fjalët e tjera emërtuese në formën e tyre të thjeshtë, të cilat u përmendën më lartë. Përdorimi i fjalës *arth si emërtim më vete, në formën e saj të thjeshtë, si dhe në kompozitë me fjalë të tjera është tregues, që kjo fjalë kishte një rëndësi të veçantë, ose një kuptim të veçantë për përdoruesit e saj.

Fjalën *arth e gjejmë si pjesë përbërëse të emërtimeve të tjera kompozitë, si tek emërtimet Maskarth dhe Karthneka, ndërsa tek emërtimet Tartaj (t/art/ aj), apo Thartor (Th/art/or) ajo shfaqet në përbërjen e rrënjës së fjalës, në një formë më të shkurtër *art. Fakti që fjala *arth krijon kompozitë edhe me fjalë të tjera, përforcon lidhjen e të gjitha këtyre fjalëve me emërtimet ilire dhe prejardhjen e tyre nga ilirishtja në mënyrë reciproke.

Një fakt tjetër që provon plotësisht prejardhjen ilire të fjalës *arth është emri i fisit ilir Arthitae i krijuar po me fjalën *arth, i cili është plotësisht i njëjtë me emërtimin e sotëm të fshatit Arthi në komunën e Lurës. Emërtimi ilir Arthitae provon njëkohësisht që të gjitha emërtimet e sotme, të cilat kanë në përbërjen e tyre fjalën *arth, si dhe elementin fjalëformues *ar i përkasin periudhës ilire të vendosjes si emërtim dhe si rrjedhim edhe fondit të ilirishtes, të cilat kanë mbetur në përdorim deri në ditët e sotme nga periudha ilire. Ky fakt është dëshmi që edhe emërtimet e tjera të sotme i përkasin fondit të ilirishtes.

Elementi fjalëformues *ar është lidhur jo vetëm me rrënjën *kus për të krijuar një emërtim të ri, por atë e gjejmë si element fjalëformues edhe tek një numër i madh emërtimeve të tjera, si para,- ose si prapashtesë. Përmendim këtu emërtimet e krijuara mbi bazën e rrënjëve *kos dhe *koz dhe me elementin *ar, si tek emrat e fshatrave Kozare në Lushnje, Kozaric në Kosovë, Kostar në Delvinë.

Pra rrënjët e fjalëve *kus, *koz dhe *kos janë lidhur me të njëjtin element fjalëformues *ar për të krijuar emërtime të reja, si tek emrat, Kusar/i, Kozar/e, Kostar. Këto emërtime tregojnë ngjashmëri midis tyre, sepse kanë në përbërjen e tyre të njëjtin element fjalëformues *ar, por para së gjithash për mënyrën e tyre fjalëformuese, e cila është e njëjtë tek të gjitha këto emërtime. Këto fakte gjuhësore janë tregues të prejardhjes së rrënjëve të këtyre emërtimeve nga ilirishtja.

Të dyja fjalët *kus dhe *arth i përkasin fondit të ilirishtes, fjala *kus i përket fondit të ilirishtes, sepse ajo ka krijuar kompozitë me fjalën *arth, Kusarth, dhe me elementin *ar, Kusari, ndërsa më lartë u sollën arsyet e prejardhjes ilire të fjalës *Arth. Si rrjedhim i përkasin fondit të ilirishtes edhe rrënjët *kos dhe *koz, sespe ato janë lidhur me të njëjtin element fjalëformues *ar, njëjloj si emërtimet Kusarth dhe Kusari, dhe sepse kanë të njëjtën mënyrë fjalëformuese.

Edhe një tregues tjetër gjuhësor i këtyre emërtimeve flet për prejardhjen ilire të rrënjës *kos. Mënyrën fjalëformuese të emërtimit Kostar e gjejmë edhe tek emërtime të tjera të ngjashme me të, si për shembull tek emri Mbrostar në Fier, ku vihet re elementi i përbashkët *ar, por edhe elementi tjetër fjalëformues *ost, i cili nga ana tjetër është pjesë përbërëse e rrënjës së fjalës Kostar:

Mbr + ostar dhe K + ostar
Mbro + st / ar dhe Ko + st / ar

Një emërtim tjetër i ngjashëm me emërtimin Kostar është emërtimi i thjeshtë Starje, ku vihet re elementi *ar në përbërjen e rrënjës së kësaj fjale. Tek të tre emërtimet Kostar, Mbrostar dhe Starje vihet re elementi tipik i ilirishtes *st, prandaj të tre emërtimet i përkasin fondit të emërtimeve ilire. Kështu edhe emërtimi Kostar, i cili ka në përbërjen e tij dy elementë të ilirishtes, elementin *ar dhe elementin *st i përket fondit të ilirishtes dhe si rrjedhim i përket këtij fondi edhe rrënja *kos e këtij emërtimi. Këtu u përshkruan dy mënyra të ndryshme, të cilat e lidhin rrënjën *kos me emërtimet ilire dhe tregojnë prejardhjen e saj nga gjuha ilire.

Fakti gjuhësor që duhet vënë në dukje në këtë pikë të analizës është para së gjithash që kemi të bëjmë me elementë të njëjtë fjalëformues, të cilët i përkasin gjuhës ilire si dhe me mënyrë të njëjtë fjalëformuese tek emërtime të ndryshme, e cila është tipike ilire.

Me rëndësi të veçantë është fakti që dy prej këtyre emërtimeve gjenden në pjesën jugore të Shqipërisë, emërtimi Kozare në Berat dhe emërtimi Kostar në Delvinë, ndërkohë që emërtimin Kozarica plotësisht i njëjtë me emërtimin Kozare e gjejmë në Kosovë. Distanca gjeografike midis këtyre emërtimeve tregon që këto fjalë emërtuese kanë qënë të njohura për të dy dialektet e ilirishtes, si të thuash këto emërtime i përkasin fondit të përbashkët emërtues të një gjuhe.

Prania e këtyre emërtimeve tek të dy dialektet e shqipes dëshmon që kemi të bëjmë me elementë fjalëformues të së njëjtës gjuhë si dhe me mënyrë fjalëformuese që i përket po asaj gjuhe, ku bëjnë pjesë edhe këta elementë fjalëformues dhe si rrjedhim kemi të bëjmë me të njëjtën popullsi, e cila fliste të njëjtën gjuhë dhe zgjidhte nga fondi i gjuhës së saj të njëjtat fjalë, të njëjtët elementë fjalëformues dhe vendoste shpesh të njëjtat emërtime, si në veri dhe në jug. Për të gjitha arsytet e përmendura deri tani këto emërtime kanë karakter mbarëgjuhësor dhe i përkasin fondit të përbashkët të ilirishtes.

Përdorimi i të njëjtit emërtim, ose i emërtimeve të ngjashme, për të emërtuar vende apo vendbanime si në veri, ku flitet dialekti i gegërishtes, ashtu edhe në jug, ku flitet dialekti i toskërishtes, është dëshmi e traditës së përbashkët ilire, e cila tregon për artin e karakteristik ilir të emërtimit, i cili nga ana e tij i përgjigjet mentalitetit ilir, si dhe dijeve dhe njohurive që ata kishin mbi emërtimin e vendbanimeve të tyre dhe vendeve në natyrë dhe të cilën e shohim kudo, ku kanë patur vendbanimet e tyre fiset ilire.

Siç do të vihet re edhe më poshtë, zgjedhja e fjalëve emërtuese për të emërtuar një vend të caktuar nuk ishte një zgjedhje e rastësishme, por një zgjedhje e paramenduar dhe e përlogaritur me saktësi, deri tek elementët fjalëformues të emërtimit dhe deri tek përcaktimi i gjinisë së emërtimit me anë të elementëve të caktuar gjuhësor. Gjithçka i përgjigjet traditës së emërtimit dhe rregullave gjuhësore të gjuhës, në përputhje me njohuritë dhe dijet që fiset ilire kishin mbi botën dhe kozmosin.

Këtu do të vëmë në dukje edhe një karakteristikë të gjuhës ilire: sipas gjuhëtarit Kretshmer edhe ilirishtja ashtu si shqipja e sotme ka patur dy dialekte. Këtë karakteristikë ai e kishte vënë re tek shkrimet e fiseve ilire të zonës Apulo-Kalabreze, në jug të Gadishullit Apenin, të cilët flisnin, sipas tij, dialektin e toskërishtes, ndërda fiset ilire Venete në veri të këtij Gadishulli flisnin dialektin e gegërishtes.

Dëshmi e prejardhjes ilire të elementit fjalëformues *ar janë emra të fiseve ilire dhe emërtime të vendbanimeve të tyre, të cilët kanë në përbërjen e tyre këtë element. Si shembuj do të sjellim emrin e fisit ilir që u përmend më lartë, Arthitae si dhe emrin e fisit tjetër ilir Armistae, ku elementi *ar shfaqet në fillim të këtyre fjalëve.

Këtë element të ilirishtes e gjejmë edhe në përbërjen e një numri të madh emërtimesh të sotme, tek të cilët ai shfaqet edhe si parashtesë dhe si prapashtesë. Prej tyre do të përmendim vetëm disa emërtime, ku ky element shfaqet në fillim të fjalës, ose si pjesë përbërëse e rrënjës së fjalës, ose si parashtesë: Armiraj, Arst, Armen, ... etj.

Prania e këtij elementi si parashtesë tek emërtimet e sotme është fakt i rëndësishëm gjuhësor që dëshmon që këto emërtime i përkasin periudhës ilire. Një fjale të huazuar nga një gjuhë tjetër mund ti vendoset mbaresa e gjuhës huazuese, por është e vështirë të krijosh një formë të re fjale me anë të një parashtese, të krijosh një lidhje gramatikore midis fjalës së huazuar dhe elementëve fjalëformues të gjuhës huazuese të kësaj forme. Krijimi i një fjale me anë të parashtesës presupozon zakonisht që krijuesit e kësaj fjale e njohin kuptimin e rrënjës së fjalës, së cilës i vendosin një element fjalëformues si parashtesë, kuptimin e së cilës ata gjithashtu e njohin ashtu sikurse njohin edhe ndikimin që ka kjo parashtesë tek kuptimi i formës së re të krijuar me anë të saj. Prandaj ky bashkim bëhet me një qëllim të caktuar, dhe ka si premisë njohuri paraprake mbi të dy elementët fjalëformues. Për këtë arsye të gjitha emërtimet e krijuara me anë të një parashtese i përkasin fondit të ilirishtes dhe si rrjedhim edhe emërtimet e sotme të krijuara me parashtesa të ilirishtes, pra edhe emërtimet e përmendura më lartë i përkasin periudhës ilire. Parashtesat dhe praparashtesat janë elementë fjalëformues të një gjuhe, të cilat japin informacione të rëndësishme mbi prejardhjen gjuhësore të një emërtimi.

Fakti që rrënjët *kos dhe *kus i gjejmë të lidhura me elementë të ndryshëm fjalëformues, si *ar, *ur, *an, *tin, ... etj, tregon që këto rrënjë nuk janë shfaqje të veçanta, të izoluara, statike, tek një fjalë e vetme, siç do të ndodhte në rastin e një fjale të huazuar, por elementë të rëndësishëm fjalëformues të gjuhës, elementë në lëvizje, elementë në përdorim të vazhdueshëm, elementë krijues, të cilët bashkohen me elementë dhe forma të tjera, krijojnë emërtime të reja, kuptime të reja, nunanca të reja kuptimore, si të thuash elementë që jetojnë brenda gjuhës dhe shfaqen me një larmi të madhe brenda saj, pra janë tek ilirishtja në shtëpinë e vet.

E njëjta analizë, që u përdor për kompozitat Kusarth dhe Kusari do të përdorej edhe për dy kompozitat e tjera Kosaçi dhe Kosmaçi, ku rrënja *kos e këtyre dy kompozitave është lidhur me fjalët e ngjashme *s/açi dhe *sm/açi, të cilat kanë si element të përbashkët pjesëzën fjalëformuese apo fjalën *açi. Për këtë arsye analiza e këtyre dy kompozitave do të përqëndrohet vetë tek ato të dhëna, të cilat sjellim informacione, të cilat nuk u përmendën tek analiza më lartë.

Po të mbështetemi tek ideja që bashkëtingëllorja *ç pasqyron transformimin gjuhësor të togut bashkëtingëllor *st/ts apo *tsh/sht, atëherë elementi apo fjala *açi do të ketë patur një formë më të hershme të ngjashme me formën *atsi. Forma *atsi është plotësisht e pranueshme, sepse ajo ka në përbërjen e saj elementin *at, të cilin e gjejmë në përbërjen e një numri të madh emërtimesh, si tek emërtimet: Bamatat, Brailat, Bularat. Ballagat, Deshat, si dhe tek shumë emërtime të tjera.

Tek të gjitha këto fjalë elementi *at shfaqet si prapashtesë e këtyre fjalëve. Duke u nisur nga ideja që edhe elementët gjuhësorë nuk zgjidhen kuturu, por mbi bazën e një logjike të caktuar gjuhësore dhe ata kanë një kuptim të caktuar, do ta lidhja kuptimin e kësaj pjesëze, apo më saktë të kësaj fjale *At, me kuptimin e fjalës së shqipes *at/ati/atit.

Pranimin që pjesëza *at është përdorur tek emërtimet kompozitë me këtë kuptim, e mbështesin disa emëtime kompozitë të sotme, të cilat e kanë këtë fjalë në përbërjen e tyre dhe tek të cilat është i njohur kuptimi i fjalëve përbërëse. Sjellim si shembull emërtimin Malati, i cili ka në përbërjen e tij fjalën *at dhe fjalën *mal, ku është i njohur kuptimi i fjalës *mal, prandaj logjika të çon që fjala *at do ti jepte kësaj kompozite kuptimin “mali i atit/ mali i babait”.

Ky kuptim bëhet i pranueshëm, nëse do të futeshim më thellë në analizën etimologjike të kuptimit të emërtimeve, të cilat e kanë këtë element si pjesë përbërëse të formës së tyre gjuhësore, si emërtimet Bularat, Brailat, ku vihen re edhe elementë të tjerë fjalëformues të njohur, si *ar, *il, *bri, ... etj. Këtu nuk do të analizohet më tej etimologjia e kuptimit të këtyre fjalëve, por do të vihet në dukje që edhe rrënja *kos ka patur një kuptim të caktuar dhe mesa duket ka patur një kuptim me rëndësi të veçantë për ata që e përdorën atë si emërtim në formën e saj të thjeshtë dhe në kompozitë me fjalë të tjera themelore, si fjala *ar, apo *at, ... etj.

Në këtë pikë do të vihet në dukje edhe një tregues tjetër gjuhësor, i cili lidhet me formën e sotme gjuhësore, me të cilën shfaqen emërtimet kompozitë, i cili tregon që këto emëtime kanë qënë për një kohë të gjatë në përdorim, që nga periudha ilire. Tregues i kësaj dukurie është pikërisht pranimi që fjala *açi ruan në vetvete kuptimin e fjalës *At të shqipes.

Kjo dukuri vihet re edhe tek të gjitha ato kompozita, të cilat kanë qënë për një kohë të gjatë në përdorim. Gjatë përdorimit për një kohë të gjatë të emërtimeve kompozitë format fillestare të fjalëve përbërëse të kompozitës janë lidhur kaq ngushtë me njëra-tjetrën saqë ato janë transformuar brenda kompozitës dhe kanë humbur disi format e tyre fillestare dhe si rrjedhojë nuk është e lehtë të përcaktohet kuptimi i tyre tek format e sotme.

Një fjalë, e cila është në përdorim për një kohë të gjatë, mund të transformojë tingujt e saj përbërës, mund të humbasë tinguj fillestar, mund të marrë tinguj plotësues, ose mund të transformoj tingujt e fjalëve fillestare në tinguj të ngjashëm me ta.

Këta tinguj të humbur ose të transformuar kanë qënë hallkë e rëndësishme lidhëse midis tingujve të fjalës, nëpërmjet të cilit shprehej kuptimi i të gjithë fjalës, ose kanë qënë hallkë lidhëse midis fjalëve të kompozitës, i cili përcillte kuptimin e fjalëve përbërëse si dhe të gjithë kompozitës.

Ai tingjull, ose ata tinguj kanë qënë të njohur për krijuesit e kompozitës. Kjo dukuri vihet re edhe tek dy kompozitat Kosaçi dhe Kosmaçi, ku bashkëtingëllorja *m shfaqet tek një kompozitë, por jo tek kompozita tjetër, dhe i jep atyre kompozita kuptime të caktuara. Në këtë mënyrë janë transformuar kompozitat emërtuese që takojmë sot, të cilat ose kanë humbur tinguj të caktuar, ose tingujt e tyre përbërës janë transformuar në tinguj të tjerë, saqë nuk mund të përcaktohet qartë kuptimi i fjalëve fillestare, që janë bashkuar në kompozitë si dhe kuptimi i kompozitës së sotme. Ky fakt gjuhësor është dëshmi që këto emëtime kanë qënë për një kohë shumë të gjatë në përdorim, dhe që ato i përkasin periudhës ilire.

Për të gjetur kuptimin e këtyre kompozitave është i domosdoshëm një zbërthim etimologjik shumë i kujdesshëm, ku të mbahen parasysh të gjitha karakteristikat e gjuhës.

Si përfundim mund të themi që edhe dy kompozitat Kosaçi dhe Kosmaçi dëshmojnë për prejardhjen ilire të fjalës *kos, sepse ajo është lidhur në kompozitë me të njëjtën fjalë *smaçi/saçi dhe sepse këto emërtime kompozitë tregojnë të njëjtën mënyrë fjalëformuese, e cila është tipike për ilirishten. Fakti që e njëjta kompozitë përdoret si emërtim në vende të ndryshme, largë nga njëri/tjetri, dëshmon për prejardhjen ilire të këtyre fjalëve.

Si përfundim mund të themi që edhe këto dy kompozita, Kosaçi dhe Kosmaçi, të cilat kanë në përbërjen e tyre fjalën e përbashkët *kos janë tregues të rëndësishëm që rrënja *kos i përket fondit të ilirishtes. Forma gjuhësore e këtyre kompozitave tregon që nuk kemi të bëjmë me një shfaqje të izoluar dhe të vetme të rrënjës *kos, apo me lidhjen e saj në një kompozitë të caktuar, të vetme, po me faktin, që ajo krijon forma të ndryshme të larmishme, qoftë tek emërtimet kompozitë, qoftë tek emërtimet e krijuara me elementë të ndryshëm fjalëformues.

Format e këtyre kompozitave janë tregues që kemi të bëjmë me traditën dhe kulturën ilire të emërtimit, ato mbështesin analizën mbi fjalëformimin e emërtimeve kompozitë të ilirishtes dhe janë dëshmi e trashëgimisë së tyre nga periudha ilire.

Një tregues tjetër gjuhësor që flet për prejardhjen ilire të rrënjëve *kos dhe *kus, i cili u përmend disa herë më lartë, janë emërtimet e krijuara me anë të këtyre rrënjëve, por me elementë të ndryshëm fjalëformues, si elementët *an, *ar, *in dhe *en.

Këtu do të përmendim edhe një element tjetër fjalëformues, elementin *ur, i cili është i ngjashëm me elementin *ar dhe është përcaktuar nga gjuhësia krahasuese si element tipik i ilirishtes.

Prej emërtimeve të sotme, të cilët kanë në përbërjen e tyre elementin fjalëformues *ur, përmendim emrat e fshatrave Kostur (*ur) në Shqipëri dhe Kosuriq (*ur) në Kosovë. Emri Kostur është krijuar njëloj si emri Kostar që përmendëm më lartë, por me prapashtesën *ur. Shfaqja e rrënjës *kos me elementë të ndryshëm fjalëformues si dhe me një mënyrë fjalëformuese, të cilën e gjejmë tek një numër i madh emërtimeve dhe e cila është tipike për gjuhën ilire, janë fakte gjuhësore përcaktuese në përkatësinë e rrënjëve *kos dhe *kus tek gjuha ilire dhe para së gjithash përcaktimin e tyre tek periudha ilire e emërtimeve.

Si përfundim jemi plotësisht në gjendje të themi që rrënjët *kos dhe *kus, të cilat i gjejmë të lidhura me elementë të ndryshëm fjalëformues të gjuhës ilire, i përkasin gjuhës ilire, si rrjedhim i përkasin kësaj gjuhe edhe emërtimet e krijuara me këto rrënjë të cilat janë trashëguar nga periudha ilire.

Kjo logjikë do të përdoret edhe për emërtimin Kosova, i cili ka në përbërjen e tij rrënjën *kos dhe për këtë arsye, ashtu si shumë emërtime të tjera të krijuara me këtë rrënjë, i përket fondit të ilirishtes dhe si rrjedhim periudhës së emërtimeve ilire, i cili dhe ka mbetur prej asaj kohe në përdorim deri në ditët e sotme. Kjo analogji është një prej dëshmive të shumta që flet për prejardhjen ilire të emrit Kosova. Fakte të tjera gjuhësore, për të cilat do të flitet në vazhdim të kësaj analize mbështesin dhe provojnë plotësisht rezultatet e deritanishme.

Emërtimet Trikota, Okosnica dhe Tankosiqi

Informacione të rëndësishme gjuhësore për përcaktimin e rrënjës *kos tek fondi i gjuhës ilire sjellin tre emërtime, të cilët kanë në përbërjen e tyre pikërisht këtë rrënjë fjalëformuese: Trikota, Okosnica dhe Tankosiqi. Këto emërtime ruajnë në përbërjen e tyre elementë gjuhësor të ilirishtes, të cilat vërtetojnë plotësisht dhe lejojnë përcaktimin e rrënjës *kos dhe si rrjedhim edhe të emrit Kosova vetëm tek fondi i gjuhës ilire.

Emërtimi Trikota

Emërtimi Trikota është një emërtim, i cili i përket periudhës ilire, sepse kjo fjalë ka mënyrë të njëjtë fjalëformimi me një emër tjetër ilir, me emrin Triteuta,¹⁹ i cili njihet si një nga fjalët më të hershme të gjuhës ilire. Të dyja fjalët Tri-kos/a dhe Tri-teut/a kanë të përbashkët elementin fjalëformues *tri, prandaj edhe emërtimi Trikota i përket fondit të ilirishtes, atij fondi që i përket edhe emri Triteuta. Mënyrën e njëjtë të fjalëformimit midis këtyre dy fjalëve e mbështet edhe emri tjetër ilir Dyteuta: Dy - teuta.

Ngjashmëria që këto dy emërtime tregojnë në mënyrën e fjalëformimit është nga ato fakte gjuhësore që dëshmojnë që emërtimi Trikota i përket periudhës më të hershme ilire dhe si rrjedhim edhe rrënja *kos në përbërjen e këtij emërtimi i përcaktohet direkt kësaj periudhe të hershme ilire.

Elementin fjalëformues *tre e gjejmë jo vetëm tek emërtimi Trikota, por edhe tek emërtime të tjera si p.sh. tek emërtimet Trebinjë, Tremul, Treska, Trestenik, Patresh, Pashtresh, Petrelë, Ostren, si dhe tek emërtime të tjera. Siç vihet re elementi *tre shfaqet tek këto emërtime si në fillim të fjalës ashtu edhe brenda strukturës së fjalës.

Akoma më tej, tek emërtimet e sotme gjenden edhe emërtime vetëm me elementin *tre, si për shembull emrat e fshatrave Tresh, Treh dhe Tren.

Prania e të gjitha këtyre emërtimeve me elementin fjalëformues *tre tregon që nuk kemi të bëjmë me një shfaqje të vetme, me një mënyrë fjalëformimi të një emri të vetëm, vetëm tek emri Trikota, por me një mënyrë fjalëformimi që është përdorur tek shumë emërtime, pra me një mënyrë fjalëformimi që është karakteristike për një gjuhë.

Fakti që elementin fjalëformues *tre/*tri e gjejmë edhe brenda strukturës së fjalës, tregon që ai është element aktiv, i cili merr pjesë tek mënyra të ndryshme fjalëformuese dhe ky fakt mbështet dhe provon që këtyre emra i përketin periudhës më të hershme ilire.

Emërtimi Okosnica

Emërtimi Okosnica, i cili ka gjithashtu në përbërjen e tij rrënjën *kos, ruan në strukturën e fjalës së tij elementë gjuhësor, të cilët kanë qënë elementë tipik fjalëformues të strukturës së fjalëve emërtuese ilire.

Tek emërtimi Okosnica është ruajtur zanorja *o në fillim të fjalës, e cila ka qënë element tipik i shumë emërtimeve ilire njëloj si zanorja *a në fillim të formës gjuhësore të fjalëve emërtuese të ilirishtes. Të dyja zanoret, edhe zanorja *a edhe zanorja *o në fillim të fjalës, kanë rënë pothuajse tek të gjitha emërtimet e trashëguara nga periudha ilire. Ato janë ruajtur tek disa emërtime, si p.sh. tek emërtimi Okosnica, si dhe tek disa emërtime të tjetra, si tek emërtimet Oman, Omaraj, Ogren, Odriçan, Ostren, ... etj,

¹⁹ Emri Teuta është emër ilir dhe njëkohësisht edhe emër pellazg, sepse këtë emër e gjejmë is emër të njerëzve të ndryshëm edhe tek fiset pellazge.

si dëshmi e ekzistencës së tyre tek struktura gjuhësore e emërtimeve ilire. Këtu do të vihen në dukje emërtimet Ostren dhe Odriçan, të cilët ruajnë edhe zanoren *o në fillim të fjalës edhe elementin fjalëformues *tre të ilirishtes, për të cilin u fol më lartë. Pra kemi tek i njëjti emërtim dy karakteristika të fjalëformimit si dhe elementin fjalëformues *tre të ilirishtes. Edhe këto dy emërtime dhe karakterisitkat e tyre gjuhësore dëshmojnë që emërtimi Okosnica i përket periudhës ilire.

Pikërisht prania e zanores *o në fillim të fjalës tek emërtimi i sotëm Okosnica është treguesi gjuhësor që ky emërtim dhe si rrjedhim edhe rrënja *kos e këtij emërtimi i përkasin periudhës ilire, të cilat kanë ruajtur formën e tyre të asaj periudhe. Tek fjala Okosnica rrënja *kos është pjesë e një emërtimi, struktura gjuhësore e të cilit është ndërtuar sipas artit ilir të ndërtimit të fjalës dhe me elementë tipik ndërtues që karakterizojnë këtë art, prandaj edhe kjo rrënjë i përket fondit të ilirishtes dhe bashkë me të edhe të gjitha fjalët që janë krijuar me këtë rrënjë.

Këtu do të vëmë në dukje edhe një tregues tjetër gjuhësor, i cili dëshmon që emërtimi Okosnica i përket periudhës ilire. Emërtimi Okosnica tregon ngjashmëri me emrin ilir Kousines, sepse ai ka në përbërjen e tij elementë të njëjtë fjalëformues me këtë emër: O/kosn/ica – Kousin/es, ku vihen re elementët e ngjashëm gjuhësor *kosn - *kousin.

Me rëndësi të veçantë është edhe fakti që rrënja *kos e emërtimit Okosnica shfaqet me zanoren *o në ndryshim nga emri Kousines, i cili shfaqet me togun zanor *ou në rrënjën e tij.

Kjo shfaqje gjuhësore tek këta dy emërtime mbështet analizën që do të bëhet në vijim, ku do të bëhet fjalë për ekzistencën e emërtimeve ilire, të cilët ishin të ngjashëm në mënyrën e fjalëformimit me emrin Kousines, por kishin patur në rrënjën e tyre zanoren *o dhe të cilët bënin pjesë tek e njëjta familje gjuhësore si edhe emri Kousines. Pra emri Okosnica, e cila i përket periudhës ilire, është tregues i ekzistencës së atyre emërtimeve ilire, të cilët kanë qënë të ngjashëm me emrin Kousines dhe të cilët kanë patur në rrënjën e tyre zanoren *o, njëllonj si emri tjetër Kosin dhe emri i sotëm Kosova. Ky fakt gjuhësor mbështet përfundimin që emri Kosova është një formë e transformuar e një emërtimi të hershëm ilir, të ngjashëm me emërtimet Kousines dhe Okosnica.

Të gjithë këta tregues gjuhësor janë dëshmi që ndjekin njëri-tjetrin dhe të gjithë sëbashku provojnë plotësisht prejardhjen e emrit Kosova nga kjo familje gjuhësore e emërtimeve ilire dhe që ky emërtim i përket periudhës ilire të emërtimeve.

Emërtimi Tankosiqi

Emërtimi Tankosiqi është një emërtim kompozitë, i cili përbëhet nga fjala *kos dhe nga fjala *tan. Fjala *tan është një fjalë e gjuhës ilire, sepse atë e gjejmë si pjesë përbërëse të emërtimeve ilire kompozitë.

Përdorimi i fjalës *tan në kompozitë me fjalën *kos paraprihet nga fakti që krijuesit e kësaj kompozite njihnin kuptimin e këtyre dy fjalëve, prandaj i lidhën ato me njëra-tjetrën për të krijuar emërtimin kompozitë Tankosiqi. Fakti që fjala *tan gjendet si pjesë përbërëse e emërtimeve më të hershme ilire, tregon që ajo i përket fondit më të hershëm të ilirishtes, si rrjedhim i përket këtij fondi edhe rrënja *kos, e cila ka krijuar kompozitë me fjalën *tan tek emërtimi Tankosiqi.

Ilirët kanë përdorur si emërtime ato fjalë të gjuhës së tyre, të cilat kanë patur një kuptim dhe një domethënie të veçantë për ta. Fjala *tan ka një kuptim specifik dhe ky kuptim i veçantë i saj tregon që edhe fjala *kos ka patur një domethënie të veçantë për fiset ilire.

Lidhja në kompozitë e këtyre dy fjalëve thekson domethënien dhe kuptimin e rrënjës *kos dhe tregon për vendin e veçantë që ajo kishte në fondin e fjalëve dhe kompozitave emërtuese të ilirishtes dhe që këtë domethënie të veçantë ruan në vetvete edhe emri Kosova, pjesë përbërëse e së ciës kjo rrënjë është. Kjo temë do të trajtohet më gjatë tek analiza etimologjike të kuptimit të emrit Kosova.

Fjalën ilire *tan e gjejmë si pjesë përbërëse edhe tek emërtime të tjera të sotme, si tek emërtimet Gajtan, Kaltanj, Koshtan, Frashtan, Broshtan, Peshtan, ... etj. Shfaqja si pjesë përbërëse e emërtimeve të ndryshme dëshmon që elementi *tan ka qënë një element aktiv në procesin e fjalëformimit të emërtimeve të kompozitave të ndryshme dhe ka patur një kuptim të veçantë.

Si përfundim do të paraqitet edhe njëherë në mënyrë të përmbledhur rezultati i analizës së këtyre tre emërtimeve: emërtimet e sotme Trikosa, Okosnica dhe Tankosiqi ruajnë në vetvete elementë fjalëformues si dhe mënyrë fjalëformimi të cilat janë tipike për gjuhën dhe emërtimet ilire, të cilat mund të vëzhgohen nga afër, si të thuash të preken me dorë tek këto emërtime dhe tek emërtime të tjera të ngjashme me to. Fakti që rrënja *kos shfaqet tek këto emërtime, të cilat tregojnë karakteristik të gjuhës ilire, është një fakt gjuhësor sigurt që rrënjë *kos dhe si rrjedhim edhe emri Kosova i përket fondit të ilirishtes. Para së gjithash ato tregojnë që emri Kosova i përket periudhës ilire të emërtimeve, i cili, ka mbetur në përdorim nga ajo periudhë e hershme e historisë deri në ditët e sotme ashtu sikurse edhe këto tre emërtime dhe emërtimet e tjera të ngjashme me ta.

Kompozitat zinxhirë të ilirishtes

Një tregues tjetër i rëndësishëm, i cili dëshmon, që rrënja *kos e emërimit Kosova si dhe emërtimet e krijuara mbi bazën e kësaj rrënje i përkasin periudhës ilire është edhe një karakteristikë e veçantë që vihet re tek emërtimet kompozitë të sotme. Thelbin e kësaj dukurie e përbën lidhja zinxhir që vendosin emërtimet kompozitë me njëri-tjetrin nëpërmjet fjalëve përbërëse të tyre. Fakti që këtë veçori dalluese të emërimit e gjejmë pothuaj tek të gjitha emërtimet kompozitë, ajo përbën një dukuri të veçantë të mënyrës emërtuese në traditën ilire të emërimit, për emërtimin e së cilës është përdorur termi “kompozitat zinxhirë të ilirishtes,” ose shkurt “kompozitat zinxhir”, me anë të të cilit tregohet lidhja midis emërtimeve kompozitë tek emërtimet e sotme.

Dukurinë e “kompozitave zinxhir” e gjejmë pothuaj tek të gjitha emërtimet kompozitë të përmendura tek kjo analizë dhe në mënyrë të veçantë tek emërtimet, të cilat kanë në përbërjen e tyre rrënjët *kus dhe *kos.

Si shembull të kësaj dukurie do të sjellim emrin Kuzmin, i cili është krijuar mbi bazën e rrënjës *kuz = *kus, e cila formon kompozitë me fjalën *min. Fjalën *min e gjejmë më tej si pjesë përbërëse të emrit Maminë, i cili është emri i një fshati në rrethin e Tiranës. Pra fjala *min ka krijuar kompozitë me elementin *ma, ndërkohë që të dyja fjalët kanë të përbashkët elementin *min: Kuz/min – Ma/min.

Elementin *ma të emrit Mamin e gjejmë në kompozitë tek emërtime të tjera, p.sh. tek emërtimet Mamel, Mamëz, Mamaj, ... etj, ku ai shfaqet në kompozitë me fjalët *mel, *mëz, *ma. Fjalët përbërëse të këtyre emërtimeve *mel, *mëz, *ma, i gjejmë si elementë përbërës të emërtimeve të tjera, p.sh. fjalën *mel të emrit Mamel e gjejmë si pjesë përbërëse të emërtimeve Hajmel, Çizmeli, Melan, ... etj, kurse fjalën *mëz të emrit Mamëz e gjejmë ose në kompozitë ose si element përbërës të emërtimeve Mëzezi, Kimëz, Gramëza, Kamëz, Mëzi, ... etj. Akoma më tej, elementë përbërës të emërtimeve të fundit, si për shembull elementin *gra/m të emrit Gramëza e gjejmë në kompozitë tek emërtimet Gramsh, Ngraçan, Ngraçie, ... etj, dhe në këtë mënyrë krijohet lidhja zinxhir midis fjalëve përbërëse të emërtimeve kompozitë.

Tek këto kompozita vihet re një dukuri e jashtëzakonshme e traditës ilire të emërimit, e artit të saj të rrallë në mënyrën e emërimit të vendeve dhe vendbanimeve, para së cilës mund të mbetesh vetëm e shtangur edhe pse domethënia e kësaj mënyre emërtuese është e panjohur.

Të gjitha emërtimet e përmendura tek temat e trajtuara më lartë janë pjesë përbërëse e kompozitave zinxhirë, janë të lidhura zinxhir në një mënyrë apo në një tjetër. Analiza e emërtimeve që u përmendën më lartë do të bëhet tek kjo nëntemë nga këndvështrimi i kompozitave zinxhir, i cili sjell informacione të reja gjuhësore mbi këto emërtime, të cilat mbështesin dhe njëkohësisht vërtetojnë plotësisht rezultatet e nxjerra deri tani nga analiza e tyre krahasuese.

Prej emërtimeve të përmendura më lartë do të sjellim si shembull emërtimet Kukur dhe Kukuçovë, të cilët kanë në përbërjen e tyre elementin fjalëformues *ku, të cilët u përcaktuan si emërtime të fondit të ilirishtes, pikërisht për praninë e këtij elementi të përbashkët fjalëformues në përbërjen e tyre. Fjalë përbërëse të këtyre emërtimeve i gjejmë si fjalë përbërëse të emërtimeve të tjera, të cilat nga ana e tyre lidhen me emërtime të tjera dhe krijojnë në këtë mënyrë lidhjen zinxhirë midis kompozitave: p.sh. fjalën *kur të emrit Kukur e gjejmë të lidhur jo vetëm me elementin *ku, por edhe me elementin *at si tek emërtimet Kuraten dhe Kurat. Elementin *at të këtyre emërtimeve e gjejmë si pjesë përbërëse tek emërtimet Tisat, Llazat Luzat, Manati, Malinati, ... etj.

Prej fjalëve përbërëse të këtyre emërtimeve zgjedhim fjalën *man të emërtimit Manati, të cilën e gjejmë si pjesë përbërëse tek emërtimet Amanikaj, Oman, Temani, Mangull, Mansuri. Prej fjalëve përbërëse të këtyre emërtimeve zgjedhim elementin *sur të emërtimit Mansuri, të cilin e gjejmë si pjesë përbërëse tek emërtimet Surrel, Surroj, ... etj, ose fjalën *gullë të emrit Mangull, të cilin e gjejmë si pjesë përbërëse të emrave Mëgullë, Mgullë, Bargullasi etj, dhe në këtë mënyrë do të gjenim lidhjen e fjalëve të këtyre kompozitave me fjalët e emërtimeve të tjera dhe si rrjedhim edhe rrugën e vargut të kompozitave zinxhirë.

Duke u nisur nga një emërtim i caktuar, pavarësisht cili emërtim do të merret si pikënisje, fjalët përbërëse të tij vendosin lidhjen me fjalët përbërëse të emërtimeve të tjera dhe krijojnë një lidhje zinxhirë me anën e së cilës krijohet një rrjet kompozues emërtimelesh.

Pothuaj të gjithë emërtimet, në një mënyrë apo në një tjetër, janë të lidhur zinxhir me njëri-tjetrin, madje edhe kompozitat e thjeshta janë pjesë e kompozitave zinxhirë, të cilat luajnë një rol lidhës të veçantë dhe përcaktues në rrjetin e emërtimeve. Në këtë mënyrë na shfaqet një pamje e jashtëzakonshme e emërtimeve gjeografike, të cilët janë të lidhur me njëri-tjetrin zinxhir dhe krijojnë me këtë lidhje një rrjet emërtues, i cili është baza e traditës ilire dhe artit ilir të emërtimit. Kjo dukuri që karakterizon emërtimet e sotme nuk është trajtuar më parë nga këndvështimi i lidhjes së tyre zinxhir dhe i rrjetit emërtues që ato krijojnë me këtë lidhje.

Dukuria e kompozitave zinxhir tregon që emërtimet e trashëguara nga periudha ilire nuk janë emërtime të rastësishme, të vendosura kuturu, por të menduara dhe të paramenduara: rregullsia e jashtëzakonshme që ato tregojnë në lidhjen e tyre me njëra-tjetrën, në zgjedhjen e fjalëve emërtuese, të elementëve të tyre fjalëformues, në zgjedhjen e vendeve dhe të distancave gjeografike të vendosjes së tyre, janë tregues themelor që kemi të bëjmë me një krijim të paramenduar, krijuesit e të cilit, njihnin arsyen e kësaj rregullsie në zgjedhjen dhe vendosjen e emërtimeve të caktuara si dhe qëllimin e kësaj mënyre emërtuese. Disa prej këtyre kompozitave krijojnë një rrjet në rrafshin paralel dhe disa të tjera në rrafshin vertikal dhe të tjera janë paracaktuar për krijimin e lidhjeve në rrafsh të tjera më të gjera hapësinore ... etj. Duke vëzhguar këtë dukuri të lind vetvetiu pyetja: cili ishte funksioni i kësaj mënyre emërtuese? Ishte ky rrjet emërtues “matriksi” Ilir?

Dukuria e emërtimeve kompozitë si dhe lidhja zinxhir e kompozitave emërtuese në një rrjet të gjerë kompozues, me karakteristikat tipike të gjuhës ilire, me elementë tipik fjalëformues të ilirishtes, është një nga provat themelore që vërteton që të gjitha emërtimet e sotme, të cilat janë pjesë e këtij rrjeti kompozues, i përkasin periudhës ilire dhe më saktë, i përkasin periudhës më të hershme të ekzistencës së botës ilire, sepse vetëm ata e njihnin artin e veçantë të kësaj mënyre emërtuese dhe dinin arsyet e përdorimit të tij.

Tek kjo lidhje zinxhir mund të vëzhgohet qartë fondi i fjalëve emërtuese dhe i elementëve fjalëformues që fiset ilire përdornin për të emërtuar vendbanimet e tyre, arti i veçantë me të cilin janë zgjedhur rrënjët e fjalëve, elementët e tyre fjalëformues si dhe lidhja e tyre në kompozitë brenda fjalës dhe me fjalët e tjera emërtuese, si dhe intesiteti dhe venddodhja e këtyre emërtimeve në rrjetin emërtues.

Dukuria e kompozitave zinxhirë është një nga faktet më të rëndësishme dhe thelbësore që vërteton plotësisht prejardhjen ilire të rrënjës *kos të emrit Kosova, sepse ajo ashtu sikurse edhe shumë emërtime të tjera të thjeshta është pjesë e rrjetit të emërtimeve ilire, është hallkë e rëndësishme në këtë zinxhir kompozitash, pa të cilën ky rrjet emërtimeesh nuk mund të ekzistojë. Kjo është edhe arsyeja përse këto emërtime kanë mbetur në përdorim deri në ditët e sotme, sepse ato “duhet” të jenë në përdorim në këtë formë që i takojmë sot.

Kjo dukuri e mënyrës emërtuese të ilirëve vendos urën lidhëse kohore midis emërtimit të sotëm Kosovë dhe emërtimeve ilire të antikitetit të krijuara me rrënjën *kos, është dëshmia më e rëndësishme që kjo fjalë i përket kohëve më të hershme të ekzistencës së botës ilire, e cila ka mbetur në përdorim nga ajo periudhë e panjohur e historisë.

Dukuria e emërtimeve të njëjta tek tradita ilire

Një veçori tjetër dalluese që karakterizon rrjetin e emërtimeve të sotme sjell informacione të tjera mbi traditën dhe artin e veçantë që ilirët kanë përdorur për të emërtuar vendet dhe vendbanimet e tyre dhe si rrjedhim edhe fakte të tjera në lidhje me përcaktimin e prejardhjes gjuhësore të emrit Kosova.

Kjo veçori u vu në dukje tek analiza e emërtimeve që u zhvillua më lartë, si tek emërtimi i vendeve të ndryshme me emrin Kosova si dhe tek emërtimet e sotme të krijuara me rrënjët *kus dhe *kos. Tek kjo nëntemë ajo do të trajtohet më gjerë dhe nga këndvështrimi i emërtimeve të lidhura me njëra-tjetrën në një rrjet emërtues si dhe nga këndvështrimi i rrjetit të emërtimeve kompozitë zinxhirë.

Po të vëzhgosh shpërndarjen gjeografike të emërtimeve të sotme, të bie në sy, që i njëjti emërtim është përdorur si fjalë emërtuese për të emërtuar vende të ndryshme dhe shpesh vende, të cilët ndodhen largë nga njëri-tjetri. Këto emërtime të njëjta i gjen të shpërndara në mënyrë të njëtrajtshme tek të gjitha trevat e banuara nga shqiptarët. Duke ecur nga jugu drejt veriut do të gesh shpesh emërtime që përsëriten vazdimisht tek të gjitha trevat e banuara nga shqiptarët. Kjo karakteristikë e veçantë që vihet re tek emërtimet e sotme, tregon që kemi të bëjmë me një dukuri tjetër të traditës ilire të emërtimit të vendeve dhe vendbanimeve, e cila është e ngjashme me dukurinë e emërtimeve kompozitë zinxhirë. Kjo dukuri vihet re edhe tek emërtimet që kanë në përbërjen e tyre rrënjët *kos, *kus, *koz dhe *koc, i cili mund të vëzhgohet tek materiali i emërtimeve të sjellë më lartë.

Në vijim do të sillen disa shembuj të tjerë, të cilët pasqyrojnë këtë dukuri të emërtimeve të sotme, dhe të cilat tregojnë më tej, që kjo dukuri përfshin jo vetëm emërtimet e krijuara me rrënjët *kos, *koc dhe *kus, ... etj, por një numër të madh emërtimelesh.

Si shembull të kësaj dukurie sjellim emrin e qytetit të Fierit, të cilin e gjejmë përsëri si emërtim tek emri Fierzë në Elbasan, Fierzë kemi edhe në Rubik, Fierzë kemi në Pukë, Fierzë kemi në Tropojë, Fier-Seman po në rrethin e Fierit dhe me emrin Fierzë njihet edhe një fshat në Kosovë. Të njëjtën karakteristikë e gjejmë edhe tek emërtimet e krijuara me anë të rrënjës *lum: Lumth në Kolonjë, Lumaj në Moglicë, Lumalas në Korçë, Lumas në Berat, Lumas në Cërrik, Lumas në Pogradec, Lumbardhë në Pukë, Lumë në Kukës. Përmendim edhe mërtime të krijuara me rrënjën *kut: Kutal në Përmet, Kutalli në Berat, Kutë në Mallakastër, Kutërqarrë në Gramsh, Kutinë në Lushnje, Kuturman në Librazhd si dhe Kutlloci dhe Kutnja në Kosovë.

Si përgjithësim mund të themi që duke u nisur nga viset më jugore, të cilat janë të njohura si vendbanime të shqiptarëve dhe duke ecur në drejtim të veriut do të takosh shpesh të njëjtin emërtim, i cili përsëritet në mënyrë të rregullt, në distanca të caktuara gjeografike. Këto emërtime të krijojnë përshtypjen sikur ato përsëriten paralelisht dhe vertikalisht në mënyrë të njëtrajtshme nga jugu në drejtim të veriut.

Kjo karakteristikë e veçantë që vihet re tek emërtimet e sotme, tregon që kemi të bëjmë me një dukuri tjetër në mënyrën emërtuese të vendeve dhe vendbanimeve, e cila është e ngjashme me dukurinë e emërtimeve kompozitë zinxhirë.

Tek këto emërtime lidhja kompozuese krijohet jo midis fjalëve përbërëse të emërtimeve kompozitë, por midis vendbanimeve me të njëjtën fjalë, e cila luan në këtë mënyrë rolin e hallkës lidhëse në rrjetin e emërtimeve: midis emërtimeve të njëjta nga njëra anë dhe emërtimeve përreth tyre nga ana tjetër. Lidhjen kompozuese këto emërtime e krijojnë në natyrë, në hapësirë, midis vendeve, ku ato shfaqen si emërtim, të cilat piketohen nëpërmjet këtij emërtimi dhe nëpërmjet tij vendosin lidhjen midis tyre. Kjo dukuri e veçantë e mënyrës emërtuese të krijon përshtypjen sikur këto emërtime, të cilat përsëriten vazhdimisht tek emërtimet gjeografike funksionojnë si pika lidhëse midis vendeve të ndryshme në natyrë nga njëra anë dhe emërtimeve të tjera përreth tyre nga ana tjetër, duke krijuar një lidhje të dyfishtë, një lidhje kompozuese në plan, në rrjetin emërtues dhe një lidhje kompozuese në “hapësirë”, në natyrë, ndërmjet vendeve të ndryshme.

Pra këto emërtime piketojnë dhe lidhin me njëri-tjetrin vende të ndryshme në rrjetin e emërtimeve dhe luajnë në këtë mënyrë rolin e hallkës lidhëse midis emërtimeve në dy rrafshme të ndryshme.

Edhe kjo dukuri që vihet re tek emërtimet e sotme është një dëshmi e rëndësishme, e cila tregon që të gjitha ato emërtime që janë pjesë e kësaj dukurie i përkasin periudhës ilire dhe akoma më tej, ato i përkasin periudhës më të hershme të ekzistencës së botës ilire, të cilët njihnin këtë mënyrë të veçantë emërtuese si dhe funksionin, arsyen e kësaj mënyre emërtuese.

Më lartë u vu në dukje që emrin Kosova e takojmë si emërtim në vende të ndryshme, si në Bosnje, në Maqedoni, në Kroaci dhe në Shqipëri. Këto emërtime me emrin Kosova, të cilat takohen largë nga ajo trevë që sot njihet me këtë emër, pasqyrojnë pikërisht këtë dukuri të artit ilir të emërtimit që u përshkrua më lartë.

Në mënyrë të përmbledhur do të thoshim: kjo dukuri tregon që emërtimet e vendeve të ndryshme me emrin Kosova nuk janë as rastësi dhe as një shfaqje e çoroditur, por ndjekin një rregullsi të caktuar në rrjetin e emërtimeve ilire, rregullsinë e mënyrës dhe traditës ilire të emërtimit, e cila kishte një arsye, një funksion dhe një qëllim të caktuar. Gjithashtu ajo tregon, që emërtimet e vendeve të ndryshme me emrin Kosova, nuk janë një shfaqje e vetme, e izoluar, vetëm tek ky emër, por kemi edhe një numër shumë të madh emërtimesh të tjera, të cilat tregojnë të njëjtën karakteristikë dhe të cilat janë pjesë e kësaj dukurie të traditës ilire të emërtimit.

Pikërisht kjo dukuri, e cila pasqyrohet edhe tek emërtimet me emrin Kosova, e lidh këtë emërtim me të gjitha emërtimet e tjera të sotme, i lidh emërtimet me emrin Kosova me rrjetin e emërtimeve ilire si dhe me emërtimet kompozitë zinxhir dhe si rrjedhim e lidh këtë emërtim me traditën e emërtimit ilir, e cila është treguesi bazë dhe më i rëndësishëm që vërteton përkatësinë e këtij emri tek fondi i emërtimeve ilire.

Emri Kosova i përket atij grupi emërtimesh të fondit të fjalëve emërtuese të ilirishtes, të cilat luajnë një rol të dyfishtë në rrjetin e emërtimeve: nëpërmjet rrënjës *kos ky emër vendos lidhjen me emërtimet kompozitë, të cilat janë të lidhura zinxhirë në rrjetin e emërtimeve, ndërsa si fjalë emërtuese në vende të ndryshme, ky emërtim shërben si nyje lidhëse midis vendeve të ndryshme në natyrë, pra është pjesë përbërëse e dy rrafshve emërtuese në rrjetin e emërtimeve.

Duke pasqyruar me këtë shpërndarje një karakterisitkë dalluese të traditës ilire të emërimit, vendoset lidhja midis këtij emri dhe emërtimeve ilire të antikitetit, midis këtij emri dhe gjuhës së fiseve, të cilët ishin banorët e këtyre viseve në antikitet, ku ky emër shfaqet si emërtim

Emërtimi Kosova, të cilin e gjejmë si emërtim edhe në Maqedoni, Dalmaci dhe Bosnjë është dëshmi e gjuhës që flisnin banorët e hershëm të atyre trevave në antikitet, është dëshmi e pranisë së fiseve ilire, të cilët i kanë patur vendbanimet e tyre pikërisht në ato treva, ku emri Kosova gjendet edhe sot si emërtim, të cilët i kanë emërtuar vendbanimet e tyre në përputhje me traditën dhe mënyrën e jetesës së tyre.

Edhe sot gjenden të shpërndara kudo në Ballkan emërtime të njëjta, të cilat emërtojnë vende të ndryshme dhe pasqyrojnë këtë dukuri të traditës ilire të emërimit dhe bëjnë pjesë tek rrjeti i emërtimeve ilire. Ekzistenca e tyre është tregues që ato emërtime i vendosën fiset ilire dhe popujt e tjerë që jetojnë sot në Ballkani i mësuan ato emërtime nga fiset ilire, kur erdhën në këto anë.

Kjo dukuri sëbashku me dukurinë e kompozitave zinxhirë është një provë tjetër e rëndësishme dhe themelore që tregon që emri Kosova i përket periudhës më të hershme të emërtimeve ilire, që ky emër ashtu sikurse edhe shumë emërtime të tjera është trashëguar nga periudha ilire dhe vazhdon të përdoret deri në ditët e sotme.

Fiset ilire dhe Europa e vjetër

Këtë karakteristikë të traditës ilire të emërimit që e gjejmë tek emërtimet e sotme, e gjejmë njëkohësisht me ngjyra të theksuara edhe tek emërtimet ilire të antikitetit, tek të gjitha ato vende, të cilat njihen si vendbanime ilire.

Studimet e shumta mbi gjuhën ilire janë mbështetur midis të tjerash dhe kryesisht tek emërtimet ilire të antikitetit. Në bazë të analizës gjuhësore të këtyre emërtimeve gjuhëtarët gjermanë do të vinin në dukje: duke u nisur nga pjesa më jugore e kontinetit European dhe duke ecur drejt veriut të Europës, do të gjesh tek emërtimet e antikitetit emërtime, të cilat përsëriten në mënyrë të rregullt. Nga analiza krahasuese gjuhësore e tyre është arritur në përfundimin që ato janë emërtime ilire dhe vendet tek të cilat ato shfaqen janë përcaktuar si vendbanime të fiseve ilire. Pothuaj e gjithë Europa e vjetër ka qënë e banuar nga fiset ilire, të cilët do të emërtonin me fjalët e gjuhës së tyre vendet dhe vendbanimet më të rëndësishme. Sipas gjuhëtarëve lumenjtë më të rëndësishëm të Europës, malet dhe vargmalet e saj më të lartë, duke futur këtu edhe Alpet, liqenet dhe lumenjtë, përrenjtë dhe në përgjithësi rrjedhat e ndryshme ujore, në përgjithësi Hydronimia e Europës së vjetër, duke futur këtu edhe emrin e detit Baltik si dhe një numër i madh emërtimeve të tjera mbajnë emra ilirë.

Mbi bazën e analizës së këtyre emërtimeve gjuhëtarët e fundit të shekullit të 19 dhe të fillimit të shekullit 20 do të arrinin në përfundimin: duke u nisur nga pjesa më jugore e kontinetit European, Greqia antike, ishujt e Egjeut dhe vendet e Azisë së Vogël, të cilat në antikitet kishin qënë të njohura si vendbanime të fiseve pellazge, dhe duke ecur në drejtim të veriut, i gjithë Ballkani, pothuaj i gjithë Gadishulli Apenin, Europa qëndrore, Zvicera, Gjermania, Austria, Polonia, Çekia si dhe vendet Baltike, pra deri në Detin Baltik, pjesë të Belgjikës, të Francës dhe Hollandës deri në ishullin Britanik në veriperëndim, por edhe pjesë të Gadishullit Iberik në jugperëndim si dhe Hungaria dhe Rumania në lindje, pothuaj i gjithë kontinenti European, kishte qënë i banuar në antikitet nga fiset ilire. Një hapësirë me përmasa imponuese, thotë gjuhëtari Krahe. Pjesa më e madhe e emërtimeve të Europës së Vjetër kanë qënë emërtime ilire, shumë prej të cilave takohen edhe sot të pandryshuara dhe të tjera të transformuara. Tek këto emërtime fiset ilire lanë gjurmët e ekzistencës së tyre, si banorët më të hershëm të këtyre vendeve.

Duke u mbështetur tek kjo logjikë është plotësisht e pranueshme që edhe emërtimi Kosova është një emërtim ilir.

Emërtimet Kushnini dhe Kosin dhe prejardhja ilire e emrit Kosova

Analiza e emrit Kosova do të vazhdojë tek kjo nëntemë në rrafshin e krahasimeve gjuhësore me emërtimet e tjera, ku do të kushtohet vëmendje e veçantë emërtimit Kushnini në Prizren, si dhe emërtimit Kosin në Përmet pasi ai ata përcjellin informacione të rëndësishme në lidhje me përkatësinë e emrit Kosova tek gjuha ilire.

Rëndësia e kësaj analize qëndron tek lidhja që vendoset midis emrit ilir Kousines dhe emërtimit të sotëm Kushnini dhe tregon që ky emër është një formë e transformuar e emrit ilir Kousines, ose i një emërtimi, i cili bënte pjesë tek e njëjta familie gjuhësore si emri Kousines.

Ngjashmëria në mënyrën e fjalëformimit dhe të elementëve fjalëformues që fjala Kushnini dhe fjala ilire Kousines tregojnë me njëra-tjetrën, janë fakte gjuhësore që dëshmojnë që kemi të bëjmë me një proces transformues të fjalës Kousines nga periudha ilire, e cila shfaqet sot me një formë të transformuar, tek forma e emrit Kushnini.

Kjo e dhënë tregon fillimisht që fjala Kousines ka kaluar nëpër një proces transformues dhe e dyta është transformuar jo në një formë të vetme, por në forma të ndryshme, njëra prej të cilave është forma e fjalës Kushnini dhe tjetra, forma e fjalës Kosova.

Prania e emrit Kushnini vërteton procesin transformues të emërtimeve ilire, të cilat shfaqen sot me forma të transformuara dhe si rrjedhim është tregues që edhe fjala Kosova është një formë e transformuar ose e emrit Kousines, ose e një emërtimi ilir të ngjashëm me fjalën Kousines.

Nga krahasimi i emërtimeve Kushnini dhe Kousines kemi mundësi të shikojmë elementët gjuhësor që tregojnë lidhjen midis këtyre dy fjalëve, të cilët janë njëkohësisht fakte gjuhësore që dëshmojnë transformimin e saj tek forma e sotme.

Faktet gjuhësore, të cilat provojnë që emri Kosova është një formë e transformuar e një emërtimi ilir dëshmojnë njëkohësisht që emri Kosova nuk është emër i huazuar dhe nga ana tjetër plotësojnë corpusin e fakteve gjuhësore që provojnë përkatësinë e këtij emërtimi tek fondi i emërtimeve ilire.

Emërtimi Kushnini, siç u vu në dukje edhe më lartë ka ngjashmëri me emrin ilir Kousines, veçanërisht me mënyrën e fjalëformimit dhe elementët fjalëformues të kësaj fjale. Ngjashmëria midis këtyre dy fjalëve vihet re fillimisht tek prapashitesa *in e ilirishtes në përbërjen e tyre. Bashkëtingëllorja *s tek fjala Kousines përfaqësohet nga bashk. *sh tek fjala Kushnini. Bashkëtingëlloret *s dhe *sh i përkasin grupit të bashkëtingëlloreve frikative, të cilat gjatë një procesi transformues të fjalës, mund të zëvendësojnë njëra-tjetrën, përkatësisht bashk. *s mund të shndërrohet në një bashkëtingëllore frikative *sh, *z, *zh ... etj. Të dyja fjalët Kushnini dhe Kousines, kanë ngjashmëri gjuhësore me emërtimet ilire që u analizuan më lartë, e cila vihet re tek prania e togut zanor *ou dhe zanores *o të rrënjëve *kous dhe *kush të këtyre emërtimeve.

Lidhjen gjuhësore midis këtyre dy emërtimeve e tregon edhe emërtimi i fshatit Kosin në rrethin e Përmetit, i cili ka ngjashmëri të theksuar me formën e emrit Kousines. Ky fakt tregon që kemi të bëjmë me dy emërtime të sotme, Kosin dhe Kushnini, të cilët janë forma të transformuara të fjalës Kousines, ose forma të emërtimeve, të cilët ishin të ngjashëm me emrin Kousines dhe bënin pjesë tek e njëjta familie gjuhësore.

Kjo do të thotë që ose togu zanor *ou i emërtimit Kousines është transformuar tek këto dy fjalë, Kushnini dhe Kosines, përkatësisht në zanoren *u dhe në zanoren *o, ose format e hershme të emërtimeve ilire, të cilat ishin të ngjashme me emrin Kousines, kanë patur në rrënjët e tyre përkatësisht zanoren *u dhe zanoren *o, të cilat janë ruajtur tek emërtime e sotme. Ky pranim ka si premisë që emërtimet e hershme ilire bënin pjesë tek e njëjta familie gjuhësore, ku bënte pjesë edhe emri Kousines, emërtimet e së cilës shfaqen me togun zanor *ou, me zanoren *u si edhe me zanoren *o.

Ekzistencën e emërtimeve ilire që bëjnë pjesë tek kjo familie gjuhësore dhe që kishin në përbërjen e tyre zanoren *o e gjejmë tek emërtimi i emrit Okosnica, për të cilin u fol më lartë. Këtu do të vëmë në dukje që rrënja *kos e emërtimit Kosin edhe e emërtimit Okosnica, është e njëjtë me rrënjën *kos të emrit Kosova.

Edhe emri Kosin ka në përbërjen e tij prapashtesën *in, e cila tregon që disa nga emërtimet e sotme i kanë ruajtur këta elementë fjalëformues në përbërjen e tyre nga periudha ilire. Pikërisht prania e këtyre elementëve fjalëformues mbështet midis të tjerash prejardhjen e tyre nga emri Kousines. Nga njëra anë këto emërtime, Kushnini dhe Kosin, kanë ruajtur elementin fjalëformues *in, nga ana tjetër shfaqen pa mbaresën *es të emrit Kousines. Mungesa e mbaresës *es, si dhe ndryshimet e tjera midis këtyre fjalëve, flet për një proces transformues të formave të hershme të emërtimeve ilire.

Në lidhje me emrin Kosin do të përmendim edhe faktin që ky emërtim shfaqet largë nga Kosova, në pjesën jugore të Shqipërisë. Ky fakt tregon që emri ilir Kousines është përdorur si emërtim edhe në ato vise, ku është folur dialekti i toskërishtes, i cili i jep emërtimit Kousines karakter mbarëgjuhësor.

Prania e emërtimit Kosin si formë e transformuar e fjalës Kousines, tregon që nuk kemi të bëjmë me një transformim të vetëm, të izoluar, vetëm tek emërtimi Kushnini, por këtë transformim e gjejmë edhe tek emërtime të tjera. Këtë pranim e mbështetin emërtime të tjera, të cilat janë të ngjashme me këto dy emërtime, Kosin dhe Kushnini dhe të cilat janë forma që kanë rrjedhur nga një proces transformues i emërtimit Kousines ose i formave të ngjashme me të.

Si shembuj të këtyre emërtimeve përmendim emrat: Kozhen dhe Kozhnja, të cilët shfaqen me zanoren *o në rrënjën e tyre dhe tregojnë ngjashmëri me emrin Kosin. Tek këto emërtime vihet re që bashk. *s e emërtimeve Kosin dhe Kousines shfaqet ose me bashk. *z ose me bashk. *zh, ndërsa këto emërtime kanë në përbërjen e tyre përkatësisht prapashtesat *an dhe *en, të cilat gjithashtu janë prapashtesa ilire. Megjithatë ato tregojnë ngjashmëri me emrin Kosin dhe do të krijonin një nënfamilie gjuhësore me këtë emër. Ato janë tregues të proceseve transformuese të formave më të hershme të fjalëve.

Emërtimi Kuzhnen, i cili shfaqet me zanoren *u në rrënjën e tij, tregon ngjashmëri me emrin Kushnini dhe formon së bashkur me forma të tjera të ngjashme si Kushtendili dhe Kushavec një nënfamilje gjuhësore. Një ngjashmëri të theksuar emërtimi Kuzhnen tregon me emërtimin Kozhnja dhe të dy me emërtimin Kushnini.

Ndryshimet gjuhësore që vihen re tek format e këtyre emërtimeve në krahasim me emrin Kousines janë tregues që kemi të bëjmë me një proces transformues gjuhësor të formave më të hershme të emërtimeve ilire.

Për analizën që po zhvillohet ka rëndësi fakti që kemi të bëjmë me një proces transformues të emrit Kousines, i cili shfaqet sot me forma të ndryshme dhe ky proces transformues dëshmon që edhe emri Kosova është një formë e transformuar e emrit Kousines.

Një tregues tjetër gjuhësor që dëshmon për prejardhjen ilire të emrit Kosova është edhe një veçori gjuhësore për të cilën u fol disa herë gjatë kësaj analize dhe e cila do të silllet në mënyrë të përmbledhur në vijim:

Rrënjët e fjalëve, të cilat kanë në përbërjen e tyre zanoren *o, kanë edhe simotrën e tyre e cila shfaqet me zanoren *u: rrënja *kos ka simotrën e saj *kus, rrënja *koç ka simotrën e saj *kuç, rrënja *koz ka simotrën e saj *kuz, rrënja *kozh ka simotrën e saj *kuzh dhe për analogji edhe rrënja *kush ka simotrën e saj *kosh. Të gjitha këto forma kanë mënyrë të njëjtë fjalëformuese në lidhjen e tyre dyshe dhe krijojnë kontrast me praninë e zanoreve *o dhe *u në këtë lidhje.

Disa prej emërtimeve të krijuara me anë të rrënjës *kosh janë: Kosharisht, Koshorisht, Koshtan, Koshutani dhe Koshi, të cilat krijojnë një familje gjuhësore mbi bazën e rrënjës *kosh.

Ky tregues gjuhësor flet për një dukuri gjuhësore, pjesë e së cilës është edhe emri Kosova, e cila është krijuar me anë të rrënjës *kos. e cila tregon më tej që emri Kosova është pjesë e emërtimeve ilire, por jo emër i huazuar.

Tregues tjetër gjuhësor i prejardhjes ilire të emërtimeve të përmendura më lartë janë elementët fjalëformues, *an, *en, *il, *ar, *or, të cilët janë elementë tipik të ilirishtes, ndërsa bashkëtingëlloret *s, *z dhe *zh tregojnë që këto fjalë kanë kaluar në procesin transformues.

Prania e elementëve fjalëformues të ilirishtes tek emërtimet e sotme dëshmon që këto transformime kanë ndodhur brenda gjuhës ilire dhe në përputhje të plotë me ligjet e brendshme të kësaj gjuhe. Këtu nuk do të bëhet analiza gjuhësore e këtyre transformimeve, sepse do ti kalonte kufijtë e kësaj analize, por do të theksohet që edhe nëse ndonjë transformim ka ndodhur më vonë, ai është bërë në përputhje të plotë me ligjet e brendshme të gjuhës shqipe. Tregues për këtë janë elementët fjalëformues të ilirishtes tek emërtimet e sotme, të cilët ose janë ruajtur të pandryshuar, ose shfaqen të transformuar tek emërtimet e sotme.

Transformimi gjuhësor - dëshmi e prejardhjes ilire të emrit Kosova

Emërtimi Kushnini si formë e transformuar e fjalës Kousines është tregues që emërtimet ilire të Dardanisë kanë mbetur akoma në përdorim nga periudha ilire, jo vetëm në Kosovë, por edhe në vende të tjera të Ballkanit.

Fakti që emërtimet e përmendura më lartë të ngjashme me emrin Kousines shfaqen sot të transformuara dhe fakti që ky transformim është bërë në përputhje me ligjet e brendshme të ilirishtes dhe të shqipes, paraprihet nga fakti tjetër, që kjo fjalë ka qënë në përdorim të vazhdueshëm tek shqiptarët e këytere viseve. Një emërtim mund të transformohet në përputhje me ligjet e brendshme të një gjuhe, kur ai është në përdorim të vazhdueshëm nga folësit e kësaj gjuhe dhe merr forma të tjera në përputhje me të folmen e kësaj gjuhe. Ky fakt tregon akoma më tej që shqiptarët kanë qënë pa ndërprerë banorë të atyre vendeve, ku ndodhet ky emërtim, të cilët e kanë patur këtë fjalë pandërprerë në përdorim në të folmen e tyre.

Emërtimet Kushnini dhe Kosin si dhe emërtimet e tjera të ngjashme me to, të cilat janë forma të transformuar të emrit Kousines janë dëshmi e transformimeve të emërtimeve ilire, të cilat kanë qënë në përdorim të vazhdueshëm tek e folmja e shqiptarëve tek të dy dialektet dhe kanë përjetuar transformimet që përjeton një fjalë që është në përdorim të vazhdueshëm tek folësit e një gjuhe në përputhje me ligjet e brendshme të gjuhës tek e cila ajo fjalë është në përdorim.

Edhe forma e sotme e fjalës Kosova ka kaluar në një proces transformimi në përputhje të plotë me ligjet e brendshme të ilirishtes dhe të folmes së shqipes tek të dy dialektet. Kjo fjalë mund të merrte këtë formë me të cilën ne e dëgjojmë sot vetëm brenda ilirishtes dhe në përdorim të pandërprerë të kësaj fjale tek e folmja e shqiptarëve.

Kjo analizë të çon drejtpërdrejtë tek përgjithësimi që emri Kosova është një formë e transformuar e emrit Kousines, apo e një emërtimi tjetër të ngjashëm me të, dhe që ky emërtim ka kaluar në procesin transformues të ilirishtes brenda gjuhës ilire dhe brenda kësaj gjuhe ka marrë formën me të cilën e shohim sot.

Përmbledhja

Duke u mbështetur tek i gjithë materiali gjuhësor i sjellë më lartë, tek analiza krahasuese e këtij materiali si dhe tek faktet gjuhësore të nxjerra nga kjo analizë, kemi mundësi që të bëjmë përgjithësime dhe të nxjerrim konkluzione edhe për fjalën Kosova dhe prejardhjen e kësaj fjale.

Analiza gjuhësore e të gjithë këtij materiali të çon vetëm tek një përfundim, që rrënja *kos me të cilën është krijuar fjala Kosova e ka prejardhjen nga gjuha ilire dhe i përket fondit të ilirishtes. Jo vetëm rrënja *kos e kësaj fjale, por edhe elementët fjalëformues të saj, pra e gjithë fjala në formën me të cilën e shohim sot, i përket fondit të ilirishtes dhe është trashëguar në këtë formë nga periudha ilire.²⁰

Numri i madh i emërtimeve të krijuara me rrënjën *kos, të cilat i gjejmë sot të shpërndara tek të gjitha vendbanimet shqiptare, larmia e emërtimeve të krijuara me këtë rrënjë, si dhe elementët fjalëformues të ilirishtes me të cilat ajo shfaqet tek emërtime të ndryshme, janë tregues të rëndësishëm gjuhësor që flasin për prejardhjen ilire të kësaj rrënje.

Këto fakte tregojnë që rrënja *kos e emrit Kosova nuk është një shfaqje e vetme, e izoluar, statike, e ngurtësuar vetëm tek ky emër, por një element i rëndësishëm fjalëformues i ilirishtes, një element në lëvizje të vazhdueshme, në lidhje krijuese dhe kompozuese, element bashkues dhe fjalëformues, element në përdorim për të krijuar forma të reja, kuptime të reja, nuanca të reja. Ajo shfaqet në lidhje kaq të larmishme me elementë të tjerë të ilirishtes, sa që të jep përshtypjen sikur jeton brenda saj dhe vetëm brenda kësaj gjuhe ndihet në shtëpinë e vet.

Fakti që emërtimet e krijuara me rrënjën *kos shfaqen në oqeanin e emrave ilirë në Ballkan, rrethohen nga emërtimet ilire, janë tregues që provojnë që ata që i vendosën emërtimet me këtë emër ishin fiset ilire, të cilët kanë qënë banorët më të hershëm dhe të vetëm të atyre trevave, ku shfaqet emri Kosova si dhe emërtime të tjera të ngjashme me këtë emër.

Numri i madh i emërtimeve të krijuara me rrënjën e kësaj fjale e bën plotësisht të pranueshme logjikën, që fiset ilire e këtyre trevave kanë zgjedhur fjalë të gjuhës së tyre për të emërtuar vendbanimet e tyre, në bazë të artit dhe të traditës së tyre të emërtimit.

Fakti që rrënjën *kos të emrit Kosova e takojmë tek emërtime që i përkasin të dy dialekteve të shqipes, toskërishtes në jug dhe gegërishtes në veri, është tregues i rëndësishëm gjuhësor, që provon që kjo rrënjë është element krijues mbarëgjuhësor i ilirishtes prandaj edhe emërtimet e krijuara me këtë rrënjë i përkasin fondit të ilirishtes.

²⁰ Analizën gjuhësore për këtë përfundim pëmbledhës do ti gjeni në pjesën e dytë të kësaj analize.

Rrënja *kos i përket atij grupi fjalësh, e cila është zgjedhur me kujdes, në mënyrë të vazhdueshme dhe me një qëllim të caktuar nga fondi i fjalëve emërtuese të gjuhës, për të emërtuar vende të caktuara, në bazë të artit dhe traditës ilire të emërtimit.

Emri Kosova pasqyron veçortinë e traditës ilire të emërtimit dhe është përdorur si hallkë lidhëse në rrjetin e emërtimeve ilire dhe ky fakt dëshmon që kjo fjalë i përket periudhës më të hershme të botës lire. Ky emër i përket atij grupi fjalësh, e cila ka patur një domethënie të veçantë për ata që zgjedhën shpesh këtë fjalë për të emërtuar vendbanimet e tyre.

Duke u mbështetur tek të gjitha faktet e nxjerra nga kjo analizë gjuhësore, e cila u krye nga këndvështrime të ndryshme, jemi në gjendje të përcaktojmë emrin Kosova vetëm tek fondi i ilirishtes, sepse të gjitha të dhënat flasin vetëm për këtë përkatësi.

Faktet gjuhësore të përcjella përmes kësaj analize janë fundamentale dhe pasqyrojnë të vërtetën ekzistuese mbi të cilën vetëm është hedhur dritë përmes saj. Me rëndësi thelbësore është edhe përdorimi i tyre, me qëllim që ato të përmbushin funksionin e ekzistencës së tyre - për të treguar këtë të vërtetë.

Kjo analizë i jep në dorë kujtdo që përfaqëson këtë bindje, faktet gjuhësore, me qëllim që të argumentojë me siguri të plotë prejardhjen ilire të këtij emri, sepse ato janë të vetmet fakte që lejojnë përcaktimin e një fjale tek një gjuhë e caktuar.

Përveç bindjes sonë si popull në përgjithësi, rëndësi ka qëndrimi zyrtar i një vendi, në lidhje me një temë të caktuar, veçanërisht, kur ajo është objekt i diskutimit midis dy vendeve. Kjo analizë krahasuese gjuhësore si dhe të dhënat e ndryshme ekzistuese që janë përcjellë përmes saj, sjellin një mundësi të re për diskutimin e kësaj teme brenda rrethit akademik të Kosovës dhe i japin atij mundësinë për një qëndrim zyrtar të argumentuar përmes faktesh në lidhje me këtë temë.

Në pjesën e dytë do ti kushtohet vëmendje analizës gjuhësore të vetë fjalës, mënyrës së ndërtimit, të fjalëformimit dhe veçanërisht elementëve të saj fjalëformues si dhe transformimit nëpër të cilin ka kaluar kjo fjalë deri sa ka marrë këtë formë të shkruar dhe të folur me të cilën ne e njohim sot.

Fundi i pjesës së parë